Институт за комуникациски студии



Me mbikqyrje efektive kundër shfrytëzimit të tepruar të resurseve natyrore

Dokument për politikë publike për mbikqyrje të menaxhimit me lëndë të para minerale, pyje, truall dhe ujëra









Kthjellohu!

Dokumenti për politikë publike do të shërben si mjet në kampanjën për përfaqësim dhe lobim „Kthjellu“ të Institutit për studime komunikative, me të cilin do të ndikohet në procesin e sjelljes të vendimeve dhe do të thiret audience e synuar në akcion në lëminë e menaxhimit me resurset natyrore. Në dokument ka përmbajtje të dhënash dhe shqyrtim në problemet aktuale në menaxhimin me resurset natyrore të cilat kërkojnë vëmendje urgjente dhe ofrojnë zgjidhje alternative dhe rekomandime konkrete për zgjidhjen e problemeve. Dokumenti bazohet mbi hulumtime dhe intervista të njohësve të lëmisë.

Botues:
Instituti për studime komunikative
rr. „Jurij Gagarin“ 17-1-1, Shkup
www.iks.edu.mk

Për botuesin:
prof. D-r inord. Zhaneta Trajkoska

Botim:
ResPublica

Autorë:
m-r Kristina Najdovska Ilievski
Elica Paunovska, juriste e dipl.
prof. d-r Nikolla Popovski

Redaktorë:
prof. d-r. Dragan Gocevski
m-r Dejan Andonov

Përktheu:
Hana Kasapi

Dizajn grafik:
Studio Igor Delov



British Embassy
Skopje



Ky proekt është përgatitur në kuadër të programit “Bashko pikat:politika të përmirsuara nëpërmjet pjesëmarrjes të qytetarëve” i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar me mbështetjen e Ambasadës Britanike Shkup. Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin ose mendimet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Институт за комуникациски студии

respublica

Me mbikqyrje efektive kundër shfrytëzimit të tepruar të resurseve natyrore

Dokument për politikë publike për mbikqyrje të menaxhimit me lëndë të para minerale, pyje, truall dhe ujëra

Shkup,
shtator 2020

Përmbajtja

Rezyme **4**

Hyrje **6**

1. Menaxhim me resurset natyrore **9**

1.1 Menaxhim me resurset minerale 9

1.1.1 Ndotje të mjedisit jetësor të shkaktuara nga eksploatimi i lëndëve të para minerale 12

1.2 Menaxhim me pyjet 14

1.2.1 Shkretim i pyjeve të Maqedonisë 16

1.3 Menaxhim me truallin 17

1.3.1 Ndotja e truallit dhe uzurpim i tokës të përpunueshme 19

1.4 Menaxhim me ujërat nëntokësore 20

2. Probleme në realizimin e mbikqyrjes efektive të menaxhimit me resurset natyrore **23**

2.1 Mbikqyrje të menaxhimit të resurseve minerale 23

2.1.1 Probleme gjatë mbikqyrjes të menaxhimit me lëndët e para minerale 24

2.2 Mbikqyrje të menaxhimit me pyjet 27

2.2.1 Probleme gjatë mbikqyrjes të menaxhimit të pyjeve 29

2.3 Mbikqyrje e menaxhimit të tokës bujqësore 32

2.3.1 Probleme gjatë mbikqyrjes të menaxhimit të tokës bujqësore 33

2.4 Mbikqyrje e objekteve të ekonomisë së ujit 35

3. Zgjidhje alternative për përmirsimin e mbikqyrjes të menaxhimi të resursve natyrore **37**

3.1 Zgjidhje alternative për përmirsimin e mbikqyrjes inspektuese të menaxhimit me lëndët e para minerale 37

3.2 Zgjidhje alternative për përmirsimin e mbikqyrjes inspektuese të menaxhimit të pyjeve 41

3.3 Zgjidhje alternative për përmirsimin e mbikqyrjes inspektuese të menaxhimit me truallin 43

3.4 Zgjidhje alternative për përmirsimin e mbikqyrjes inspektuese të menaxhimit të objekteve të ekonomisë të ujit 45

4. Implikacione fiskale të zgidhjeve alternative për përmirsimin e mbikqyrjes të menaxhimit me resurse natyrore **47**

4.1 Implikacione fiskale të zgjidhjeve alternative për përmirsim të mbikqyrjes inspektuese të menaxhimit me lëndët e para minerale 47

4.2 Implikacione fiskale të zgjidhjeve alternative për përmirsim të mbikqyrjes inspektuese të menaxhimit me pyjet 50

4.3 Implikacione fiskale të zgjidhjeve alternative për përmirsim të mbikqyrjes inspektuese të menaxhimit me truallin 53

4.4 Implikacionet fiskale të zgjidhjeve alternative për përmirsim të mbikqyrjes inspektuese të menaxhimit me ujërat 55

5. Përfundim **58**

Bibliografia **60**

Rezyme

Dokumenti „Me mbikqyrje efektive kundër shfrytëzimit të tepruar të resurseve natyrore“ paraqet një studim profesional që adreson politika publike nga lëmia e mjedisit jetësor. Fokusi kryesor është menaxhimi me resursin natyror dhe mbikqyrje inspektuese e katër kategorive të thesarëve natyrore: lëndët e para minerale, pyjet, trualli dhe ujërat.

Në përmbajtjen e dokumentit janë prezentuar problemet që dalin nga regullativa aktuale ligjore që regullon sferat e përmendura, organet kompetente dhe institucionet që janë të detyruara në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore të veprojnë në sferat e dhëna, si dhe mbikqyrja inspektuesenjë nga segmentet më të rëndësishme, e cila mundëson kontrollë direkte mbi përdorimin e dispozitave ligjore me të cilat regullohet. Për shkak të bashkangjitjes komplementare me aktivitetet tjera të botuesit të dokumentit - Instituti për studime komunikative, i është kushtuar me pak vëmendje sferës të ujërave, sepse është objekt i një dokumenti të veçantë për politika publike. Për problemet e lidhura me mbikqyrjen inspektuese, janë propozuar zgjidhje alternative për tejkalimin e tyre dhe analizë e implikacioneve fiskale. Në pjesën e përfundimeve janë nxjerrur shënimet për sfidat specifike në mbrojtjen e menaxhimit të lëndëve të para minerale, pyjeve, truallit dhe ujërave me fokus në mbikqyrjen inspektuese në këto sfera.

Ndotja e vazhdueshme e mjedisit jetësor vjen si rezultat i vetëdijes të ulët të qytetarëve, por edhe si rezultat i mosfunksionimit të organeve dhe institucioneve shtetërore. Ndryshimet dhe plotësimet e shpeshta të dispozitave ligjore të sferës, sjellin vështirësi plotësuese në zbatimin e tyre praktik. Mospërputhja e legjislacionit e vështirëson punën efikase, jo vetëm e organeve dhe institucioneve kompetente, por edhe e të gjithë subjekteve që janë të detyruara ti respektojnë dhe ti aplikojnë aktet e përcaktuara ligjore dhe nënligjore. Ndryshimet në Ligjin për lëndët e para minerale e neglizhojnë problemin me minierat egzistuese, të cilat edhe me tej vazhdojnë të punojnë me përdorim të cijanidit dhe sulfurit. Komunikimi i pamjaftueshëm mes institucioneve sjell deri te një sërë lëshimesh dhe paregullsish, që koncesionerëve disi ja u lehtësojnë obligimet dhe detyrimet ndaj shtetit. Ndryshimet e fundit të Ligjit për pyjet janë bërë në vitin 2016 dhe ato nuk korespondojnë me zgjidhjet e reja ligjore nga sfera, të miratuara dy vitet e fundit. Nevojiten masa për ngritjen e vetëdijes shoqërore për rëndësinë e pyjeve si resurs natyror me rëndësi të madhe. Mosegzistimi i Ligjit për truallin çmundëson një regullim të plotë dhe mbrojtjen e tyre, dhe me këtë lihet hapësirë ato të jenë të lëshuara në (jo)vetëdijen e të gjitha komponentave të shoqërisë, pa ndonjë kontrollë institucionale ose e tjetër lloji për ndotjen dhe shkatërrimin e truallit. Resurs krucial, i nevojshëm për mbijetimin dhe mirëqënien e njerëzimit, si dhe për zhvillimin socio-ekonomik, është uji. Kontrolli i regullt i ujërave nëntokësore do të jepte udhëzime për

ndikimin e ndryshimeve të temperaturës mbi tokën dhe truallin, por edhe informata të dorës të parë për ndikimet e ndryshme mbi resurset ujore.

Shkalla e ulët e dënimit për shkelësit e dispozitave ligjore, edhe përkrah uljes të shumës të gjobave, u tregua se aspak nuk shkon në favor të ruajtjes të mjedisit jetësor. Në lidhje me mbikqyrjen inspektuese, që paraqet segment jashtëzakonisht i rëndësishëm nga veprimet në sferën e mjedisit jetësor, nevojitet punesim i resurseve njerëzore të duhura në çdo inspektorat dhe shërbim inspektues veçmas, sigurim i të gjitha kushteve të duhura teknike dhe materijale për punë, mjete dhe pajisje, vendosje e bazave elektronike bashkëkohore të të dhënave dhe mundësim i rrjedhjes të lirë të informacioneve të karakterit publik. Qytetarët kanë të drejtë të kenë dijeni si shpenzohen mjetet e buxhetit, dhe organet dhe institucionet kompetente kanë përgjegjësi para qytetarëve për kryerje efikase dhe efektive të detyrave në pajtim me ligjin. Perforcimi i besimit mes qytetarëve dhe organeve dhe institucioneve shtetërore kërkon respektim të vazhdueshëm dhe aplikim të legjislacionit, integritet të organeve dhe institucioneve, kryerje efektive e kompetencave dhe detyrimeve, por edhe dënim të detyrueshëm për të gjithë shkelësit e dispozitave ligjore.

Ky dokument për politika publike është pregaditur në suazat e proektit „Bashko pikat: politika të përmirsuara nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare“ të Institutit për studime komunikative, dhe me përkrahje të ambasadës Britanike në Shkup.


1.

Hyrje

Pa resurse natyrore jeta është e pamundur.nga lindja e deri në vdekje, resurset natyrore transformohen për perdorim nga ana e njeriut, ushqim,mbathje, shtëpi dhe transport .
Nga ato mvaremi për çdo nevojë materijale, komoditet, rahati dhe mbrojtje në jetët tona. Pa bollëkun e resurseve, prosperiteti është i pamundur.

-

Gliford Pinçot

Interakcioni mes njeriut dhe natyrës është evident, i dukshëm dhe nuk kërkon ndonjë shpjegim. Njerëzit jetojnë në bashkësi, ndërtojnë vende për të jetuar dhe i plotësojnë nevojat egzistenciale duke i shfytëzuar materijalet e disponueshme në mjedisin në të cilin gjinden. Druri, guri dhe mineralet nën siperfaqen e tokës janë burim i pazëvendsueshëm për ndërtimin e shtëpive, ndërtesave, rrugëve, urave, digave, energjens për nxemje, për transport, për prodhim të energjisë elektrike... Kullosat janë burim ushqimor për kafshët shtëpiake, ndërsa toka pjellore për bujqësinë. Rritja e popullatës, e përcjellur me zhvillimin teknologjik, i rriti nevojat e shoqërisë, por edhe e perfekcionoi mënyrën e shfrytëzimit të natyrës për plotësimin e nevojave të jetës të përditshme dhe ekonomisë. Ashtu ka qenë në të kaluarën, ashtu është edhe sot, dhe besojmë se ashtu do të vazhdojë të jetë edhe në të ardhmen. Jeta e njerëzimit varet nga natyra, dhe kjo nuk mund të kundërshtohet.

Ajo që mund, dhe duhet të diskutohet është mënyra dhe vëllimi i shfytëzimit të natyrës për plotësimin e nevojave shoqërore dhe ekonomike të cilat ndonjeherë janë racionale dhe ndonjeherë sjanë. Trajtimi i natyrës si “resurs” është i domosdoshëm për nocionin bashkëkohor të ekonomisë, industrisë, por gjithashtu kontribuon në çregullimin e gjendjes të mjedisit jetësor në mënyrë që nuk mund shpejtë të regullohet, dhe në ndonjë rast, aspak. Disa resurse janë të rinovueshme me kalimin e kohës, dhe nëse gjindet balanc mes dinamikës të eksploatimit dhe aftësisë të natyrës të ripërtrihet vetë(dhe ndonjëherë me ndimën e njeriut), pyjet, uji dhe fondi i peshkut mund të jenë burim i ekonomisë dhe mirëqënies. Shfrytëzimi i pakontrolluar ose i tepruar i këtyre resurseve e çregullon këtë baraspeshë në dëm të fondit pyllor, të sasisë së ujit të pijshëm, të pastërtisë të liqeneve, lumejve,

detit….Pyllëzimi i hapësirave të zhveshura është proces i gjatë, i ngadashëm dhe i pasigurtë, që ndonjëherë zgjat me dekada. Nga ana tjetër, gabimet në shfrytëzimin e disa resurseve natyrore është e pamundur të largohen. Një sipërfaqe që një herë është urbanizuar është thuajse e pamundur të përdoret persëri për bujqësi, dhe një kodër e gërrmuar, thjeshtë më nuk egziston. Për fat të keq, natyra nuk mund "vetë" të mbrohet nga eksploatimi i tepruar, dhe shpresa se vetëm vetëdija do ti vetëkufizon njerëzit nga ambiciet personale është një floskul utopike. Është i nevojshëm një arbitrarë më i lartë i cili do të mund në mënyrë racionale të vendos regulla, gjegjësisht norma, për atë se sa, dhe si do të shfrytëzohen thesaret natyrore, njëkohësisht arbitrarë me kapacitet ti imponon ato norma dhe të ketë në dispozicion mekanizma të kontrollit se sa ju përmbahen qytetarët dhe bizneset këtyre normave.

Në kohën bashkëkohore atë rol e ka shteti, si bartësi i vetëm i sovranitetit, e cila normat i shëndron në të drejtë: nëpërmjet kushtetutës, ligjeve dhe akteve të shumta nënligjore. Në shtetet në të cilat institucionet në qeverisje konstituohen me anë të zgjedhjeve demokratike dhe të drejta, së paku si parim sjellen ligje me të cilat mundësohet mirëqënie e popullatës nëpërmjet procesit i cili mund të jetë i gjatë, i ngarkuar me parakushte teknike, por edhe me bisedime të mbrendshme politike. Për atë arsye është e domosdoshme të kujdesemi për kualitetin e çdo ligji, të mundet në mënyrë të përgjithshme ti regullon "rregullat e lojës" për çdo sferë të konfliktit shoqëror, gjë që vlen në përgjithësi edhe për përcaktimin e një regjimi ligjor, i cili do të regullon kush, kur, si dhe sa mund të menaxhon me resurset natyrore, të mundëson dënime adekuate për të gjithë që nuk do ti respektojnë regullat dhe mbrojtje ligjore për të dëmtuarit. Njëkohësisht, të mundëson dhe mekanizëm për parandalim, kontrollë të asaj a respektohen regullat para se të behet thyerja e tyre. Mekanizëm më të fuqishëm që ka shteti për përcjellje të ligjshmërisë të punës dhe veprimit të qytetarëve dhe bizneseve(por edhe të institucioneve publike), janë inspektoratet dhe shërbimet inspektuese të organeve të drejtorive dhe njësive të vetëqeverisjes lokale. Kapaciteti, pajisja, edukimi, por edhe lirimi nga presionet e jashtme,është parakusht që inspektimet të munden në mënyrë efektive të kryejnë punën e tyre, e cila mund të jetë edhe parandaluese, edukative, dhe çdoherë kur është e nevojshme edhe represive.

Ky dokument për politikë publike i prezenton mangësitë në legjislacionin dhe në organet kompetente, para se gjithash të inspektorateve shtetërore, dhe ofron zgjidhje dhe rekomandime për përmirsim të dispozitave ligjore, me të cilat regullohet materiali dhe për mbikqyrjen inspektuese mbi përdorimin e tyre.

Për përpunimin e dokumentit është berë hulumtim cilësor me mbledhje të të dhënave nga burime të botuara të shtypura dhe elektronike, si dhe biseda dhe pyetësorë gjysmë të strukturuar. Në hulumtim autorët kanë

konsultuar 59 burime, që përfshijnë ligje, akte nënligjore, dokumente strategjike, programe dhe tjera burime, burime nga institucionet kompetente, janë konsultuar dhe persona zyrtarë dhe profesional të cilët punojnë në sferat e hulumtuara.

Nëpërmjet këtij publikimi lexuesi do të mund nga afër të njoftohet me regjimin ligjor, rrjetin institucional dhe sistemin e mbikqyrjes inspektuese për katër kategori të pasurive natyrore: lëndët e para minerale, pyjet, trualli dhe ujërat. Për secilën nga lëmitë e përmendura është dhënë shqyrtim dhe koment për gjendjen e sferave kur është i shkruar ky publikim(korrik-tetor 2020), vënie e akcentit në sferat problematike, rekomandime dhe llogaritje e implikacioneve fiskale për tejkalimin e tyre.


2.

Menaxhim me resurset natyrore

Resurset ekologjike dhe shërbimet që planeti Tokë mund ti ripërtrin gjatë një viti shpenzohen para kohe, dhe popullata globale shfrytëzon resurse sikur për 1,6 planete (Global Footprint Network, 2020). Organizata botërore shkencore dhe ekspertë, tregojnë për faktin se për momentin 27 mijë lloje të kafshëve dhe të bimëve ballafaqohen me rrezikun e shfarosjes. Ata e potencojnë rrezikun nga humbja e 40% te bletëve, që mund të sjellë deri te mungesa serioze e ushqimit dhe tjera shërbimeve të ekosistemit që sigurohen nga natyra. (The Conscious Challenge, 2020). Që të ndalohen keto procese, patjetër është që resurset të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme.
Në Maqedoni menaxhimi me resurset natyrore nuk është i qendrueshëm për shkak të:

- Besimi se resurset mund të jenë të pakufizuara edhe përkrah shfrytëzimit të tyre pa kontrollë;
- Shoqëria konsumatore dhe ekonomia lineare, gjegjësisht eksploatimi i tepërt i mineraleve, ujit, pyjeve dhe truallit, që sjell deri te ndotja dhe krijimi i sasive të tepruara të hedhurinave;
- Përfaqësim i pamjaftueshëm i teknologjive të reja për zvogëlimin e emisioneve, parandalimin dhe shfrytëzimin i hedhurinave;
- Joharmonizimi, zbrazëtirat ligjore dhe vështirësi në përdorimin e ligjeve që në mënyrë të kontinuar aproksimohen me të drejtën e Unionit Europjan (UE);
- Kontrolli joadekuat i eksploatimit të tepërt të resurseve dhe ndojtes.

1.1 Menaxhimi me resurset e mineraleve

Lëndët e para minerale janë materie organike dhe joorganike që gjinden në gjendje të ngurtë, të lëngshme dhe të gaztë. Ato paraqesin të mira të interesit publik dhe janë pronë e shtetit, pa marrë parasysh pronesinë e vendit se ku gjinden. Lëndët e para minerale, sipas llojit (neni. 4), mund të jenë:

- Lëndë të para minerale energjetike: të gjitha llojet e thëngjillve të fosilit, hidrokarburet në gjendje të ngurtë, të lëngshme dhe të gaztë, materiet radiokative(uran dhe torium), gjithë llojet e shkëmbinjve bituminize dhe të yndyrshme dhe gazrat e tjera që gjenden në tokë;

- Lëndë të para minerale metalike: hekur, mangan, nikël, krom, bakër, volfram, stanium, platinë, molibden, antimon, talium, arsen, merkur, argjend, arë dhe tjera lloje metalesh që mund te hasen gjatë eksploatimit;

- Lëndë të para minerale teknogjene: lëndë të para minerale të cilat krijohen në procesin e përpunimit të lëndëve të para minerale energjetike apo metalike, duke i përfshirë edhe hedhurinat e zgjyrës që krijohen gjatë eksploatimit dhe perpunimit të gurit arkitektonik dekorativ;

- Lëndet e para minerale jometalike: gëlqeror-kalcit, gëlqeror-dolomit, kuarc, kuarcit, rerë kuarci, diabaz, feldspad, tuf, gjips, basalt, grafit, perlit, liskun, grafit, laporec, andezit, magnezit, barit, gnajs, fluorit, disten, sulfur, gnajs, azbest të gjitha llojet e glinës etj;

- Gur arkitektonik dekorativ: mermer, granit, travertin, oniks, basalt, sijanit, breçe etj;

- Ujëra minerale, termominerale, termale dhe ujëra minerale dhe gaz CO2

- Rërë dhe zhavor që nuk gjenden në shtretërit dhe brigjet e trupave ujore sipërfaqësore(rrjedha uji, liqene dhe akumulacione) dhe kuarci grumbullues. (neni 4)

Mineralet paraqesin lëndë të para vitale për shumë industri bazike dhe janë resurs kryesor për zhvillim, por ato janë të kufizuara dhe nuk janë të ripërtrirshme. Për atë, menaxhimi me lëndët e para minerale është ngushtë

i integruar me strategjinë e përgjithshme të zhvillimit, ndërsa eksploatimi i lëndëve të para minerale duhet të bëhet sipas qëllimeve dhe perspektivave afatgjata nacionale. E drejta e Maqedonisë drejton dy forma të menaxhimit me lëndë të para minerale:

- Koncesion paraqet e drejta për shfrytëzim të të mirave të interesit publik për shtetin, ndërtimit që është në interes publik ose kryerja e shërbimeve publike, me kushtëzimin e koncesionerit të ndërton ose/ dhe menaxhon, ta shfrytëzon dhe ta mirëmban objektin që është dhënë në koncesion, me pagesë ose pa pagesë nga ana e koncedentit(Ligji për koncesion dhe partneritet publiko privat, neni 3 paragrafi 2). Për shembull, e drejta për eksploatim të lëndëve të para minerale fitohet me fitimin e koncesionit, e cila jepet në bazë të thirjes publike ose në bazë të kërkesës. Vendimin për dhënien e koncesionit e sjell Qeveria me propozim të Ministrisë të ekonomisë, dhe ajo shpallet në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut"(RMV). Në bazë të vendimit lidhet një marrveshje, të cilën në emër të Qeverisë e nënshkruan ministri i ekonomisë në afat prej 15 ditësh nga hyrja në fuqi e vendimit. Kjo marrveshje ka statut të dokumentit egzekutiv;

- Ekploatimi i lëndëve të para minerale është aktivitet i fitimit, gjegjësisht shëndrimit të lëndëve të para minerale nga gjendja e tyre natyrale duke i përfshirë këtu aktivitetet pregaditese, shoqëruese dhe vijuese të lidhura me fitimin e lëndëve të para minerale

- (Ligji për lëndë të para minerale, neni 3, p.1 a. 8) Eksploatimi i lëndëve të para minerale bëhet në hapesirë të caktuar, të definuar me proektin kryesor ose plotësues të minierave për eksploatim të lëndeve të para minerale.

Veprimet për shfrytëzim mund të shkaktojnë ndotje të dukshme të mjedisit jetësor dhe humbje të resurseve tjera, siç janë trualli dhe diversiteti biologjik.

Ligji për lëndë të para minerale („Gazeta zyrtare r Republikës së Maqedonisë" nr.136/12, 25/13, 93/13, 44/14, 160/14, 129/15, 192/15, 39/16, 53/16, 120/16, 189/16 и 7/19) parasheh dispozita me të cilat mund të sigurohet qëndrueshmëria e menaxhimit me resurset minerale. Në të janë përcaktuar masat dhe mënyra me të cilat ndalohet ose zvogëlohet ndikimi i dëmshëm mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve, i cili mund të shkaktohet si pasojë e menaxhimit me hedhurinat nga hulumtimi, eksploatimi dhe përpunimi i lëndëve të para minerale, domethënë është paraparë që menaxhimi me resurset natyrore të jetë në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor. Më tej, janë definuar veprimet në

minierë gjatë menaxhimit me hedhurinat e zgjyrës, që mund të rezulton me rrezikshmëri serioze për shëndetin e njeriut ose/dhe mjedisit jetësor në vetë lokacionin ose në vend tjetër, dhe janë të njohura materiet e rezikshme që shfrytezohen gjatë procesit të menaxhimit me resurset minerale, karakteristikat e të cilëve e ndotin mjedisin jetësor dhe janë të rezikshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve me efekte të dëshmuara akute, kronike, toksike dhe efekte tjera të dëmshme. Me Ligjin për lëndë të para minerale ndalohet dhënia me koncesion për eksploatim të lëndëve të para minerale me metoda te flotacionit të lëndëve të para minerale metalike me cijanid ose me acid sulfurik në minierë me pus të hapur. Përjashtim janë koncesionet për eksploatim të lëndëve të para minerale metalike të minierave egzistuese. Ligji parasheh sanim, si proces të kthimit në gjendjen të mëparshme të truallit, vendbanimeve natyrore, resurseve ujore dhe rajonit.

Që të fitohet koncesion ose leje për hulumtim ose eksploatim të lendëve të para minerale kërkohet mendim nga Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapesinor(MMJPH) në lidhje me ndikimet e mundshme që këto aktivitete do të mund ti kishin mbi natyrën dhe ujërat. Në rast të mendimit negativ nga Ministria, Qeveria mund të sjellë vendim për refuzim të dhënies të koncesionit ose licencës për hulumtim ose eksploatim të lëndëve të para minerale. Para se të miret licenca për eksploatim, koncesionerit duhet ti aprovohet studimi me vlerësim për ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe të bën kerkesë për dhënien e licencës A ose B të integruar ekologjike.

Koncesioneri i cili bën eksploatimin e lëndëve të para minerale, detyrimisht përpunon plan për menaxhim me hedhurinat nga lëndët e para minerale, program për ndalimin e reziqeve, si dhe plan të brendshëm për raste urgjente, duke i precizuar masat që do të merren në rast të fatkeqësive. Koncesioneri duhet me ngarkesë personale të merr masa për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe nëse masat adekuate nuk janë aplikuar, koncedenti mund të vendos të ndërpren kontratën për koncesion. Gjithashtu, koncesioneri është i detyruar të bën rikultivim të tokës në të cilën bëhen hulumtime të detajuara gjeologjike ose eksploatim i lëndëve të para minerale. Programin vjetor për rikultivimin e sipërfaqeve të degraduara e sjell Qeveria me propozim të ministrit të ekonomisë, ndërsa Inspektorati shtetëror për inspektim teknik(ISIT) dhe Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor(ISHMJ) sigurojnë që koncesioneri i merr masat e duhura, gjegjësisht i përmbahet standardeve të duhura dhe qëllimeve të mjedisit jetësor.

Koncesionerët pagojnë shuma të caktuara për kryerjen e hulumtimeve të detajuara gjeologjike ose eksploatim të lëndëve të para minerale, nga të cilat 22 përqind janë të ardhura për buxhetin kombëtar dhe 78 përqind transferohen në buxhetin e komunës në rajonin në të cilin kryhet veprimtaria koncesionuese. Nga të ardhurat e buxhetit kombëtar, e paraparë është që 4 përqind do të shfytëzohen për rikultivim dhe kthim i siperfaqeve të degrad-

uara në gjendje të mëparshme. Para dhënies të licencës për koncesion, koncesioneri sjell vërtetim për garancë finansiare, e cila do të jetë e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve për eliminim të efekteve të dëmshme për mjedisin jetësor nga eksploatimi, nga fatkeqësi eventuale dhe pas mbylljes të instalacionit.

1.1.1 Ndotje të mjedisit jetësor të shkaktuara gjatë eksploatimit të lëndeve të para minerale

Aktivitetet të minierës shkaktojnë ndotje të mjedisit jetësor dhe çregullim të rajonit. Natyra e ndotjes varet nga materialet që nxjerren dhe nga përpunimi i tyre i mëtutjeshëm. Minierat e thëngjillit dhe lëndëve të para metalike shkaktojnë ndotje kimike të ujërave dhe truallit dhe mundet në mënyrë serioze të ndikojnë në shëndetin e popullatës që jeton në rrethinë. Paraqitet zhurmë dhe vibracione dhe shkatërohet vendi. Ndikimet e dëmshme vazhdojnë edhe gjatë kohë, pas ndërprerjes të punës të tyre, për shkak të kullimit të ujërave nëntokësore të ndotura me ujëra të tharëta miniere dhe metale të rënda. Eksploatimi i gurit për ndërtim, zhavorit dhe rërës, ka ndikim në regjimin hidrologjik dhe rajonin, emitohet pluhur, zhurmë dhe vibracione. Përkrah ndotjes dhe efekteve negative mbi shëndetin, hapja e minierave për eksploatim të lëndëve të para minerale është e lidhur edhe me ridedikimin e tokës, devastimin të saj të pakthyeshëm dhe humbjen e diversitetit biologjik. Edhe strategjia kombëtare për mbrojtje të natyrës për periudhën prej vitit 2017-2027, përcakton se një nga kërcënimet prioritare për diversitetin biologjik janë minierat. Minierat siperfaqësore mund të shkaktojnë humbje të përhershme të vendbanimeve. Për shembull, fusha koncesionare e minieres Sasa, gjindet në vendbanim të rëndësishëm- treset dhe per shkak të obligimeve të ndërmara me marrveshjen për koncesion, shteti nuk mund ti mbron. Këto lloje gjinden edhe në Osogovë, që është regjion i mbrojtur përtej kufirit me Bullgarinë, por për shkak të eksploatimit të ardhshëm të mineraleve, propozim-kufijtë të Maleve të Osogovës janë të tërhequra, që çmundëson në të ardhmen Osogova të jetë regjion i mbrojtur përtej kufitar.

Edhe përkrah detyrimit ligjor për rikultivim të truallit të përfshirë me eksploatimin e lëndëve të para minerale, koncesionerët nuk marrin masa për kthimin e fushës ekploatuese në gjendje të dobishme, siç është rasti me disa kodra gjatë rrugës Gostivar- Kërçove që janë tërësisht të gropuara, dhe vegjetacioni është i larguar. Ndotja dhe rajoni i shkatërruar tregon në neglizhencë totale të organeve kompetente dhe të koncesionerëve për pasojat e eksploatimit të lëndëve të para minerale.

Lokacionet për vende potenciale ku mund te gjenden lëndë të para minerale janë të përcaktuara me planin Hapësinor të MMJPH në bazë të dhënave nga hulumtimet paraprake. Për planin hapësinor aktual nuk është bërë vlerësim strategjik për ndikimet në mjedisin jetësor, gjegjësisht, nuk janë marrë parasysh ndikimet kumulative nga dhënia e koncesioneve për lokacionet e planifikuara. Ministria e ekonomisë shpall tender për kryerje të hulumtimeve të detajuara gjeologjike sipas iniciativave të ndërmara private, dhe nëpërmjet veprimtarisë të paraparë me Ligjin për lëndë të para minerale dhe Ligjit për koncesione dhe partneritet privat publik. Dhënia e koncesioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale bëhet me intenzitet të madh. Ashtu për shembull, në vitin 2019, janë dhënë 358 koncesione, ndërsa në vitin 2020 janë dhënë 362 koncesione(Regjistri për marrëveshje për koncesion, 2020). Hulumtimet për arsyetimin e proekteve koncesionare i përpunojnë vetë investitorët për lokacionet e dhëna. Nuk bëhet vlerësim strategjik për mjedisin jetësor për të gjitha lokacionet që janë lëndë e dokumentacionit tenderik, dhe kjo nuk mundëson të shqyrtohen në mënyrë paralele ndikimet mbi mjedisin jetësor dhe aspektet shoqërore nga koncesionet e planifikuara, gjegjësisht të percaktohet kapaciteti ekologjik i regjionit. Në qoftë se do të kishim bërë vlerësim strategjik të mjedisit jetësor, do të kishim një krahasim mes përftitimeve për popullatën vendase nga eksploatimi i lëndëve të para minerale edhe tjerave funkcione të shfrytëzimit të tokës. Përkundër asaj, gjatë dhënies të koncesionit merren parasysh vetëm kriteret për qasje të rezervave gjeologjike dhe për përfitim.

Gjatë procedurave, ka raste të dhënies të koncesioneve dhe në regjione të propozuara për mbrojtje, gjegjësisht lokacionet e propozuara për eksploatim të lëndëve të para minerale të jenë në kufijtë e regjoneve për të cilat nuk është kryer procedurë për shpalljen e regjoneve të mbrojtura, edhe përkrah vlerave evidente natyrore që do të mund të çregullohen(Petrovska, 2020). Deri tani nuk është dhënë asnjë vërtetim me të cilën refuzohet ndonjë hulumtim për vlerësimin e ndikimeve mbi mjedisin jetësor për minierë. Hulumtimi për vlerësimin e ndikimeve mbi mjedisin jetësor në minierën për bakër Kazandoll është aprovuar, ndërsa për hulumtimin për vlerësimin e ndikimeve mbi jedisin jetësor nga miniera për arë Illovica-Shtuka ka qenë i përpunuar raport për atë a është adekuat hulumtimi, edhe përkrah vlerësimeve për ndotje kimike potenciale, rrezik për prodhimin bujqësor lokal dhe kërcënime mbi shëndetin e popullatës. Për këtë arsye, është e domosdoshme në të ardhmen, gjatë vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor nga minierat, të mundësohet publiku të merr pjesë në gjithë procedurat, dhe jo vetëm të mundësohet shqyrtim në hulumtimin në kohëzgjatje prej 30 ditë dhe të organizohet vetëm një debat publik.

1.2 Menaxhimi me pyjet

Pyjet paraqesin të mira të interesit publik dhe thesar natyror, dhe për atë gëzojnë trajtim të posaçëm dhe kanë mbrojtje të veçantë. Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 56) shkruan se "të gjitha pasuritë natyrore të Republikës, bota bimore dhe shtazore..., janë të mira të interesit publik për Republikën dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë". Sipërfaqja e përgjithshme nën pyje(shfrytëzim i tokës) është 949,329 hektarë, ose 37 perqind i gjithë teritorit të Maqedonisë. Pyjet në pronësi shtetërore mbulojnë thuajse 89 përqind nga sipërfaqja e përgjithshme nën pyje, dhe pjesa e mbetur janë parcela të vogla në pronësi private (NP „Pyjet Kombëtare", 2020).

Ligji për pyjet për herë të fundit është ndryshuar në vitin 2016 dhe ai nuk është harmonizuar me ligjet tjera relevante që kanë pasuar ndryshime gjatë viteve të fundit. Ligji parasheh se duhet të mundësohet menaxhim, planifikim, rruajtje e qëndrueshme e pyjeve, që të mirëmbahet dhe të avancohet aftësia prodhuese, diversiteti biologjik, si dhe funkcionet ekonomike, ekologjike dhe sociale të pyllit, dhe gjatë kësaj mos të çregullohet ekosistemi. Nga kjo, ligji i numron funkcionet e përgjitshme të levërdishme të pyjeve, mes të cilave janë edhe krijimi i oksigjenit dhe pastrimi i atmosferës, zhvillimi i bashkësive rurale lokale, turizmi dhe gjuetia, krijimi i kushteve të volitshme për shërim, pushim, sport dhe rekreacion, përmirsimi i pjellshmërisë të truallit dhe zvogëlimi i proceseve erozive, rruajtja e diversitetit biologjik dhe ndikimi pozitiv mbi klimën dhe ndryshimet klimatike. Për mirëmbajtjen e diversitetit biologjik, ligji parasheh këshill Kombëtar dhe rezervate pyjore dhe të gjuetisë. Sidoqoftë, ajo që Ministria për mjedis jetësor, nuk ka përpunuar katastar për regjione të mbrojtura dhe regjistër për trashëgimi natyrore e vështirëson bashkëpunimin e Ministrisë me kompetentët për menaxhimin e pyjeve, gjegjësisht integrimin e qëllimeve për mbrojtje të diversitetit biologjik në planet për shfrytëzimin e pyjeve. Plani regjional për avancimin e pyjeve është përpunuar vetëm për regjionin e Maleshevës, me të cilin përcaktohet në çfarë drejtimi do të shkon menaxhimi i qëndrueshëm me pyjet dhe reonet pyjore në regjion, në bazë të vlerave të tyre socio-ekonomike dhe biodiversitetit(rruajtja e natyrës).

Ligji për pyjet i përcakton dhe ndalesat për shkrretim dhe gërmim,dhe për ridedikim të përhershëm të tokës pyllore. Ai ndalon dhe prerje të padrejtë e cila nuk është e miratuar si masë e regullt për ripërtrirje të pyjeve në dokumentet planifikuese, si dhe prerje e drujve të rallë dhe të mbrojtur. Për popullatën që jeton në fshatrat përreth është të lejuar të shfrytëzojnë dru për plotësimin e nevojave personale, por sasia e masës të drurit e prerë në pyll shtetëror nuk duhet ta kalon ma shumë se 10 metër kub për një vit kalendarik. E ndaluar është blerja, përpunimi dhe qarkullimi i drurit që nuk

është i shënuar dhe i pajisur me fletëurdhëresë. Më tej, me ligjin ndalohet deponimi i hedhurinave, substancave të helmueshme, dhe tjetër lloj materiali në pyll, djegje dhe shkaktim të zjarrit në pyll dhe kryerje e aktiviteteve me të cilat do të intensifikohen proceset e erozionit dhe degradimit të tokës. Për dëme të shkaktuara në pyje, pagohet gjobë sipas çmimores për dëme në pyll. Pronarët dhe shfrytëzuesit e pyjeve janë të detyruar të bëjnë pyllëzim të vendeve ku ka pas zjarre, sipërfaqeve ku nuk ka pas ripërtrirje natyrore dhe pyllëzim, si dhe në sipërfaqe ku ëhtë berë shkrretim- prerje jo e drejtë e llojeve të ralla të drurit, jo më gjatë se dy vjet nga dita kur është berë çpyllëzimi. Nëse është e domosdoshme të ndërtohen objekte të interesit publik, atëherë bëhet ridedikim i tokës pyjore në tokë ndërtuese, për të cilën pagohet shumë në lartësi të vlerës për pyllëzim të sipërfaqes, aq sa është siperfaqja në të cilën është paraparë ndërtimi i objektit, masa e drurit, rritja e humbur dhe funksionet e dobishme.

Katër vite pas miratimit të Ligjit për pyjet, ende nuk ka katastar për pyje Kombëtare, edhe pse kjo është paraparë me ligj.. Nuk është bërë as regjistrim i thesarit pyllor, ndërsa ligji parasheh regjistrim të detyrueshëm çdo vit, dhe dorëzim i të dhënave deri te Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë të ujit(MBPEU). Në fillim të vitit 2018, Organizata për ushqim dhe bujqësi e Kombeve të bashkuara (FAO), ndau ndihmë financiare dhe teknike për MBPEU të zhvillon metodologji për zbatimin e inventarit kombëtar për pyjet. Është paraparë Qeveria të sjell plan kombëtar për menaxhim me zjarret në hapësirë të hapur për periudhë nga dhjetë vite, dhe për atë qëllim të formon komitet kombëtar.

NP „Pyjet kombëtare“ e përcakton vlerën e pyjeve kombëtare në bazë të Regullores për plane speciale për ekonomizim me pyjet, planeve speciale për kultivim dhe mbrojtje të pyjeve dhe plane vjetore të zbatimit. Si do qoftë, kjo regullore, në pjesën e vlerësimit të plantacioneve pyjore, nuk është harmonizuar me standardin të kontabilitetit Kombëtar 41.18- Bujqësi(Gazeta zyrtare 159/viti 2009) dhe me Ligjin për vlerësim(Gazeta zyrtare 115/viti 2000). NP “Pyjet Kombëtare” filloi proces për sertifikim të pyjeve nëpërmjet pilot-proektit për përdorim të skemës më të madhe globale sertifikiuese PEFC (Programme for Endorsement of Forest Certification), sipas të cilës janë sertifikuar mbi 300 milion hektar pyje anembanë botës.

Pyjet pjesërisht regullohen dhe me Ligjin për kullosa, i cili aspak nuk është plotësuar ose i ndryshuar që nga viti 1999. Nevoja për harmonizim të këtij ligji është më teper se e nevojshme.

1.2.1 Shkrretimi i pyjeve të Maqedonisë

Si të mira të interesit publik, pyjet dhe toka pyjore duhet të mirëmbahen, të ripërtrihen dhe të shfrytëzohen në mënyrë që të ruhet vlera e tyre dhe do të bëhet ekonomizim dhe menaxhim.

Përkundër kësaj, prerja jolegale paraqet problem serioz dhe afatgjatë, e cila e sjell në pyetje menaxhimin e qëndrueshëm me pyjet, si dhe vlerën e pyjeve në kuptim më të gjërë. Llogaritjet janë se vëllimi i drurit të prerë në mënyrë ilegale është prej 20 deri 30 përqind nga prerja e përgjithshme e masës së drurit në një vit të cakturar. Në lidhje me përhapjen e prerjes jo të drejtë të pyjeve, ajo është e përfaqësuar në gjithë teritorin e Maqedonisë, dhe sipas informatave të policisë pyjore, më së shumti kryhet në qytetet Shkup, Kërçovë, Strugë, Demir Hisar, Prilep, Manastir, Berovë, Strumicë dhe Shtip. Sipas disa ekspertëve, në vit humben përafërsisht 10 milion euro nga prerja në të zezë e pyjeve. Nga janari deri në shtator të vitit 2019, nga Sektori i Policisë pyjore, deri te prokuroritë publike të përgjithshme të shtetit janë ngritur 107 kallëzime penale, nga gjykatat themelore janë sjellur 484 gjykime me të cilat janë shqiptuar dënime prej rreth 374 mijë euro, dhe gjatë akcioneve pyjore janë konfiskuar 1800 metër kub dru, 39 kamionë, 153 automjete dhe 12 traktorë(Media Servis Maqedonas,2020). Shkatërrimi i pyjeve pjesërisht është rezultat i situatës të pavolitshme ekonomike të qytetarëve. Kryesit i përdorin drutë të prerë në mënyrë ilegale për nxemje të tyre, si resurs më i lirë dhe lehtë i disponueshëm, por motiv për prerje ilegale është edhe përvetsimi i paligjshëm i përfitimit, përkatësisht druri i prerë në mënyrë ilegale shitet "në të zezë" me çmim më të lirë(Malish Sazdovska, 2002).

Ndërmarja Publike „Pyjet Kombëtare" planifikon shfrytëzimin e pyjeve, dhe për atë përpunon plan vjetor, por aktiviteti i saj është vetëm shënimi i drurit për prerje, derisa prerja, furnizimi dhe transporti bëhet nga kompani private në bazë të tenderit. „Sipas Ligjit për thirje publike fitohen tenderët sipas çmimit më të ulët, edhe më të ulëta se çmimet e tregut- për shembull, për prerje aplikohet me 250 den për metër kub, edhe pse sipas dokumentacionit të NPPK çmimi është 360 denarë për metër kub, dhe ky dallim më tej plotësohet me sasi plotësuese të drurit për nxemje. Për ketë, normal, nuk ka të dhëna publike, dhe për atë arsye është i domosdoshëm kontroll i forcuar, posaçërisht në teren. Ajo mund të përmirësohet me aplikimin e GPS sistemeve në kamionë. Kjo është vetëm një pjesë e problemeve me të cilat ballafaqohet kjo ndërmarje e stërmadhe me afër 2500 të punësuar, ose një pjesë e zinxhirit e cila nuk fnkcionon në mënyrë përkatëse dhe e cila lejon aktivitete korruptive (prerje jo të drejta), për çka edhe shumë shkruhet nëpër mediume. Nevojitet riorganizmim i "pyjeve Kombëtare" nga ndërmarje publike, e cila edhe pse është ndërmarje publike, ajo nuk financohet nga buxheti, por nga mjete personale. Ky riorganizim do të mund

të jetë shoqëri akcionare, siç është në Slloveni, Mal të Zi dhe në Sllovaki.“ (Stojanovska, 2020).

Përveç kesaj, institucionet publike të formuara nga Qeveria për kujdesin e parqeve nacionale nuk kanë mjete të mjaftueshme finansiare që ti zbatojnë masat mbrojtëse, dhe kryesisht, fitojnë të ardhura nga prerja e pyjeve.

Shkrretimi i pyjeve është vepër penale sipas Kodit penal (neni 226). Nëse vepra është kryer në pyll të mbrojtur, park nacional, ose në ndonjë pyll tjetër me rol special, kryesi do të dënohet me dënim burg prej tre muaj deri në tre vjet. Në dispozitat penale në Ligjin për pyjet (Kreu XII), gjobat për personat juridik janë dhënë në shumë fikse dhe janë 30 mijë euro, 20 mijë euro gjegjësisht 15 mijë euro në varësi nga shkelja e ligjit, dhe gjobat për persona fizik janë nga 1500-2000 euro, si më të ulëta, dhe 3500-4000 euro si gjobë më e lartë. Nëse kundërvajtjet janë kryer nga levërdia ose me kryerjen është shkaktuar dëm më i madh në pronë, gjoba është dyfish nga ajo e parapara(dhe personit përgjegjës në subjektin juridik do ti ndalohet që të kryejë aktivitet gjatë 30 ditëve) dhe do të konfiskohen mjetet të përdorura për kryerjen e kundërvajtjes, si dhe mjetet që janë fituar në mënyrë të padrejtë me kryerjen e saj. Si do qoftë, egziston rreziku për korrupcion, dhe nëse ajo ndodh, nuk zbatohet regullativa ligjore dhe procedurat e detajuara për punë. Integriteti i shërbyesve policorë është faktor kyq për atë, se a do të ketë korrupcion ose jo. Korrupcioni në polici me shpesh vlerësohet si i “imët”, nuk zë shuma të larta për ryshfet, por përbehet nga dhurata që janë me vlerë më të vogël se vlera e dënimeve të shkruara, por rezultati është efekt i lartë i kumuluar i humbjes të të ardhurave nga dënimet në buxhetin qendror. Politika dënuese e butë, nuk e ndalon kriminalitetin, dhe veprat përsëriten (Mojsovksa, 2019).

Edhe një problem, janë zjarret pyjore, të cilat në vitet e fundit kanë zaptuar më tepër se 100 mijë hektarë dhe kanë shkatërruar një masë të madhe të drurit. Kjo paraqet problem ekonomik, por sjell edhe deri erozioni më i madh i sipërfaqeve të djegura, çregullim i regjimit ujor, humbje e vegjetacionit dhe shkrretim. Edhe ndryshimet klimatike, nëpërmjet procesit të tharrjes të pyjeve dhe dëmeve të shkaktuara nga sëmundje dhe insekte, lidhen me kercënimet kryesore dhe problemet në ekonomizimin me pyjet.

1.3 Menaxhimi me truallin

Menaxhimi me truallin duhet të siguron kualitetin perkatës, gjegjësisht karakteristikat dhe vetitë e truallit që duhet të plotësojnë nevojat e njerëzve dhe ekosistemit. Një nga karaketerisitkat e rëndësishme të truallit që duhet

të mirëmbahet për shkak të mundësimit të ushqimit është pjellshmëria, si aftësi e truallit ti furnizon bimët me materie ushqyese, ujë, ajër dhe kushte tjera të nevojshme. Trualli është resurs i kufizuar, që do të thotë se humbja dhe degradimi i tij nuk ripërtrihen gjatë jetës së njeriut. Për atë, koncepti i mundësisë dhe kapacitetit të truallit luan rol të rëndësishëm në vendimet për menaxhimin me tokën. Edhe përkrah kësaj, nuk egzistojnë politika zhvillimore dhe ligj i posaqëm për truallin, as përcjellje e gjendjes dhe kualitetit të saj, si dhe gjendjes të lokacioneve të kontaminuara në Maqedoni(RMV. MMJPH 2019: 48).

Draft-ligji për mbrojtjen e truallit është i përpunuar, por ende s'është i miratuar, sjellja e këtij ligji është e nevojshme për shkak të kufizimit të emisioneve të dëmshme në truall, identifikimit të lokacioneve të kontaminuara(vatra historike industriale) dhe përcaktimit të koncentrimeve të materieve të rrezikshme që gjinden në truall. Me këtë ligj duhet të vendoset dhe të kryhet monitoring i truallit nëpërmjet mbledhjes, perpunimit, analizës dhe validacionit të të dhënave dhe informatave për truallin, mes të cilave edhe për substancat e rrezikshme dhe për degradacionin e truallit.

Në mungesë të ligjit të veçantë për truallin, menaxhimi i saj bëhet me ligje tjera. Ligji për mjedis jetësor parasheh sjellje të katastarit për ndotësit e truallit dhe përcakton se Qeveria dhe komunat sjellin plan akcional lokal ose kombëtar për mbrojtje të mjedisit jetësor, në të cilën i përpunojnë çështjet të lidhura me ndotjen, gjegjësisht me mbrojtjen e truallit. Ky ligj thotë se gjatë përpunimit të vlerësimit strategjik të mjedisit jetësor për proekte investuese duhet të mundësohet dhe përshkrim i burimeve dhe mënyrave të ndotjes të truallit dhe të masave që do të merren për zvogëlimin e ndikimeve në kualitetin e truallit. Ligji për mbrojtje të natyrës ndalon shfytëzim të natyrës me të cilën degradohet trualli dhe humbet pjellshmëria e saj, dhe thekson se, me vlerësimin e ndikimeve mbi natyrën, të parashikohen edhe masa për ndalimin degradimit të truallit, dhe shërbimet për rroje në parqet nacionale të përcjellin nese trualli ndotet nëpërmjet menaxhimit joadekuat me hedhurina ose nëpërmjet aktiviteteve tjera. Ligji për tokë bujqësore ju urdhëron pronarëve dhe shfrytëzuesve të tokës bujqësore, ta mirëmbajnë dhe ta risin pjellshmërinë, të ndalojnë ndotjen e tij ose tjetër lloj degradimi me input të drejtëpërdrejtë të materieve të dëmshme në truall ose nëpërmjet ujit ose ajrit, para se gjithash, për shkak të prodhimit të ushqimit të regullt nga aspekti shëndetësor dhe për shkak të mbrojtjes të shëndetit të njerëzve dhe botës bimore dhe shtazore. Ministri i bujqësisë, në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e drejtorisë shtetërore kompetente për çështjet nga sfera e mjedisit jetësor, i përshkruan materiet që janë të dëmshme për tokë bujqësore, koncentrimin e tyre maksimal të lejuar në truall dhe masat që merren në tokë bujqësore që përmban koncentrime më të mëdhaja të materieve të dëmshme nga ajo që është e lejuar. Toka bujqësore mund të

ridedikohet në tokë ndërtimore nëpërmjet procedurës që e nis Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë të ujit, dhe vendim për ridedikim sjell Qeveria. Më pas mendim ofrojnë ministritë kompetente, duke e përfshirë edhe Ministrinë për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor. Nese pjesa e planit urbanisitik gjindet në rajonin e mbrojtur, Sektori për mbrojtje të natyrës në MMMPH duhet të jep mendim negativ dhe procedura për ridedikim duhet të ndërprehet. Për ridedikim të përhershëm të tokës bujqësore në ndërtimore pagohet shumë e caktuar. Toka bujqësore mund të ridedikohet edhe në tokë për eksploatim të lëndëve të para minerale.

1.3.1 Ndotja e truallit dhe uzurpimi i tokës të përpunueshme

Arsyet për humbjen e kualitetit të truallit janë shkatërrimi i karakterisitkave ujore dhe ajrore të truallit për shkak të ndërtimit të objekteve dhe zgjërimit të lagjeve, realizimit dhe funksionimit të koridoreve transportuese, eksploatimit të lëndëve të para minerale, emisionit të materieve ndotëse në truall nga kapacitetet industriale(deponi për zgjyrë dhe material tjetër që përmban materie të rezikshme), si dhe shfrytëzimi i tepruar i plehrave artificiale dhe pesticideve në bujqësi. Me ridedikim intenziv të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ose për eksploatim të lëndëve të para minerale, humbet trualli si resurs i rëndësishëm. Sipërfaqet e përpunueshme lëshohen dhe për shkak të migracionit ose për shkak të mungesës të interesit financiar për prodhimtari bujqësore, që sjell deri te degradimi i truallit.

Kur flasim për tokë bujqësore dhe për shfrytëzimin e saj, çdoherë aktuale kanë qenë problemet me ridedikim të tokave bujqësore me kualitet në sipërfaqe për tjetër rol, gjegjësisht trualli që ka kualitet të caktuar dhe përmban kushte optimale për prodhimtari bujqësore cilësore shëndrohet në tokë ndërtimore, zona të ndryshme të lira, sipërfaqe për separacion dhe nxjerrje te rërës dhe tjera, me çka në mënyrë të përhershme merret sipërfaqja për ndonjë aktivitet dhe e cila më tej nuk do të mund të përdoret për prodhim bujqësor. Me këtë humben sipërfaqe te përpunueshme cilësore të cilat në të ardhmen do të mund të ndikojnë në zvogëlimin e kulturave bujqësore dhe cilësisë së tyre, dhe me këtë ndikohet edhe në ekonomitetin e prodhimtarisë. „Maqedonia ka kartë trualli, ku janë të caktuara me tepër lloje të truallit me kualitet të ndryshëm dhe me funksion të ndryshëm- për prodhim bujqësor, kullotje, pyll, etj. Rreth 8-10 përqind nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqëore e cila është 500-600 hektarë quhen si klasë e parë dhe e dytë, të cilat janë më cilësore për prodhim bujqësor. Me Ligj përcaktohet se cilës kategori, gjegjësisht klasë i takon trualli dhe cilat kategori mund të shfrytëzohen si tokë për ndërtim, dhe cilat mund të shfrytëzohen si tokë bujqësore. Si do qoftë, me akte nënligjore duhet të regullohet që sipërfaqet bujqësore të përdoren vetëm për prodhim bujqësor, dhe ato të mos mund të ridedikohen për nevoja tjera, pëveç në rast të interesit shtetëror (ndërtim i aeroportit, autostradës etj.)“ (Profesor i shkencave bujqësore, 2020).

Gjithashtu, bëhen separacione të rërës në sipërfaqe bujqësore që janë me cilësi të lartë, më shpesh afër lumejve. „Nxjerret rërë në truall ajuvijal, përkrah lumejve, e cila është rërë e imët dhe e mirë dhe shfrytëzohet kryesisht për aktivitetet ndërtuese (rërë për bërjen e malterit etj). Ministria e ekonomisë i ndan koncesionet, por, edhe pse punimet mund të bëhen në toka më cilesi më të ulet, ajo për koncesionerët do të thotë më tepër shpenzime për përpunimin e rërës më të madhe“ (profesor i shkencave bujqësore, 2020).

Ne të kaluarën, shumë shpesh kishim shembuj në teren dhe në praksë, ku sipërfaqet e dhëna në koncesion nuk përpunoheshin ose përdoreshin në periudhë të shkurtë, ose deri në fitimin e subvencioneve. „Për shembull, mbjellen arra që kanë largësi të madhe gjatë mbjeljes(10x10 м, 100 fidane = 1 hektar), „do të futish një degë në tokë dhe do fitosh subvencione“ dhe ato pas një kohë lëshoheshin“ (profesor i shkencave bujqësore, 2020). Në kontekst të kësaj, problem të madh ishte edhe ajo, që prodhuesit që shfrytëzojnë sipërfaqe nën koncesion, posaçërisht prodhuesit e mëdhenj, si dhe ato të cilët prodhimin bujqësor e kanë veprimtari plotësuese, nuk janë të detyruar të punësojnë agronomë, me çka ulet cilësia e prodhimit, mënyra e përdorimit e sipërfaqeve dhe përdorimi i masave agroteknike.

Me hulumtime paraprake janë identifikuar 16 pika të nxehta: deponitë me lindan në oborrin e OHIS, deponitë e zgjyrës nga Shkritorja në Veles dhe në Hekurishten në Shkup, deponia e fabrikës për feronikël “Feni”, deponia për baltë kromi e “Jogohromit”, deponitë e termocentraleve në Manastir dhe në Osllomej, jallovishtet e “Toranica”, “Sasa”, dhe “Zletovo”, “Buçim” dhe deponia e minierës për arsen dhe antimon “Llojane” dhe deponia e fofoggjipsit nga fabrika e mëparshme për plehëra artificiale në Veles. Është përcaktuar se në afërsinë e këtyre lokacioneve të kontaminuara, trualli nuk është i sigurtë për prodhimin e ushqimit (Porta 3, 2018). Për pika të nxehta prioritare për sanim dhe rikultivim janë paraparë deponitë me lindan në OHIS dhe deponia e baltës kromike në Jogohrom. Për fazën e parë për pastrim të lindanit janë siguruar 3.5 milion euro dhe është angazhuar kompania. Për pastrim të tërësishëm të deponisë të vogël të lindanit duhen rreth 11 milion euro, dhe për të madhen rreth 50 milion euro.

1.4 Menaxhimi me ujërat nëntokësore

Uji paraqet resurs i kufizuar por i ripërtrirshëm, vetëm nëse me atë menaxhohet në mënyrë adekuate. Sipas Ligjit për ujëra (n. 4 p. 1, 2 и 3), ujërat i përfshijnë të gjitha ujërat sipërfaqësore(ujëra që rrjedhin dhe që nuk rrjedhin në sipërfaqen e tokës) duke i përfshirë këtu dhe rrjedhat e përhershme ose rrjedhat që ndonjëherë rrjedhin ujë, liqenet, akumulacionet, burimet dhe ujërat nëntokësore(ujërat që gjenden nën sipërfaqen e tokës në zonën e saturacionit dhe janë në kontakt direkt me sipërfaqen ose me nën shtresat). Ujërat, si të mira të interesit publik, janë në pronë të shtetit dhe ato nuk janë subjekt i të drejtës për pronësi i subjekteve fizike ose ligjore, pa marrë parasysh pronësinë e tokës se ku gjinden ato.

Ujërat nëntokesore si resurse natyrore janë të rëndësishme për ekosistemet të mvarura nga ujërat nëntokësore, si dhe për furnizimin me ujë për konsum nga ana e njeriut. Informacioni për nivelin e ujit nëntokësor është me rëndësi të madhe për bujqësinë, energjetikën dhe ndërtimtarinë. Për çdo objekt, posaçërisht në rajonet e rrezikuara nga ujërat nëntokësore, patjetër duhet të kemi dijeni për regjimin e lëvizjes të ujit nëntokesor, e cila në situata të caktuara do të mund të ndikojë në themelet ose në murret mbrojtëse të hapësirave nëntokësore. Kontrolli i regullt e ujit nëntokësor do të jep udhëzime për ndikimin e ndryshimeve të temperaturës mbi tokën dhe truallin, por edhe informacione primare për ndikime të ndryshme mbi resurset ujore. Temperatura e ujit, jep informacion direkt për varijacionet eventuale të klimës në regjion, gjegjësisht për ndryshimet klimatike. Direktiva 2006/118/EC e Parlamentit europjan dhe Këshillit të Europës nga 12 dhjetori të vitit 2006 për mbrojtje të ujërave nëntokësore nga ndotja dhe nga përkeqësimi, paraqet kornizë për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes të ujërave nëntokësore. Ajo i përfshin dhe procedurat për vlerësim të gjendjes kimike të ujërave nëntokësore dhe masave për zvogëlim të nivelit të ndotësve(RMV. MMJPH 2012).

„Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor ka vetëm rol koordinativ si autoritet në menaxhimin me ujërat, sepse sipas regullativave momentale, nuk ka instrument dhe mekanizma përkatëse, regulla të përcaktuara dhe procedura për mbrojtjen e ujërave dhe ato janë të decentralizuara, të ndara mes më tepër ligjeve dhe më tepër institucioneve kompetente. Në Slloveni, për shembull, ka një agjencion i cili menaxhon me gjitha ujërat. Do të ishte situatë ideale te transferohen regullat europjane në ligjet tona që më lehtë të menaxhohet me ujërat .“ (Krstevska, 2020).

1.4.1 Keqpërdorimi i ujit për ujitje

Tjetër problem në shfrytëzimin e resurseve natyrore në bujqësi paraqet shfrytëzimi racional i ujit për ujitje. Shembull shumë i shpeshtë në shtetin tonë është gërmimi dhe mosparaqitja e bunareve për ujitje të sipërfaqeve bujqësore. Shoqëria akcionare për ujëra ka filialet e saja nëpër gjithë shtetin, në suazat e së cilës dhe në nivel të rrjedhës lumore janë formuar sisteme hidromeliorative (SHM). Por, pjesë e madhe e sistemeve hidromeliorative janë të abandonuara dhe të prishura, dhe prodhuesit janë të detyruar të gërmojnë bunarë, të cilët, shumë shpesh nuk i paraqesin që mos të pagojnë taksa për SHM. Për shembull, në Maqedoni nuk ka të dhëna të sakta se sa bunarë egzistojnë dhe cilit rrjet i përkasin. Do të thotë, shfrytëzimi ditor i ujit nga një bunar është i kufizuar deri 10 metër kub, por në teren ajo nuk respektohet. Shteti bën përpjekje për subvencionim të ujitjes me mbulimin e një pjesë të shpenzimeve për gërmim të bunareve, si dhe shfrytëzim të sistemit "pikë pas pike", që nga ana tjetër do të mundëson dhe paraqitjen e burimit të ujit që shfrytëzohet për ujitje. Por, edhe më tej numri i bunareve të paparaqitura vazhdon të jetë shumë i madh dhe shrytëzimi i ujit si resurs natyror është pa kontrollë. Duhet plotësisht të subvencionohen bunaret, pajisjet për sigurim të ujitjes "pikë pas pike", dhe në atë mënyrë të zvogëlohet sasia e ujit që shfrytëzohet për këtë rol. Gjithashtu, edhe përkrah përdorimit të sistemeve moderne për ujitje, për ujë bëhet pagësë sipas kultures bujqësore dhe sipërfaqes, dhe jo sipas shpenzimit, sepse shpenzohet në mënyrë joracionale dhe joefikase. Nevojitet për çdo regjion dhe për çdo kulturë të bëhet llogaritje të nevojave për ujë për kulturë dhe të krijohen kushte të bëhet pagesë sipas shpenzimit, me çka do të zvogëlohet shfrytëzimi joracional i ujit dhe shfrytëzimi sipas syrit. Duhet të kthehen rrojet e ujit të cilët nëpër arra do të bëjnë kontrollë për ujitjen dhe keqpërdorimin e ujit në suazat e SHM. SHM duhet të modernizohet dhe të pajiset me mekanizëm për largimin në kohë të problemeve teknike në teren.

Në fund, duhet të përmendet se me ujitjen të paregullt dhe joracionale, problem plotësues paraqet dhe ndikimi i mjeteve për mbrojtje të plehrave të cilat, nëpërmjet ujërave nëntokësore, mund të kthehen në bunare, liqene ose në burimet me ujë që mund të përdoren dhe për diçka tjetër" (profesor i shkencave bujqësore, 2020).


3.

Problemet në realizimin e mbikqyrjes efektive të menaxhimit me resurset natyrore

2.1 Mbikqyrje mbi menaxhimin me resurset minerale

Mbikqyrja në realizimin dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit për lëndë të para minerale është në kompetencë të një numri më të madh të organeve dhe institucioneve. (neni 100).

Ministria e ekonomisë bën mbikqyrje në zbatimin e dispozitave të ligjit, ndërsa Drejtoria për të ardhura publike(DAP) bën mbikqyrje dhe kontrollë në pagesën e shumave për hulumtime të detajuara gjeologjike dhe për koncesione për eksploatim të lëndëve të para minerale. DAP është e detyruar në çdo tre muaj të dorëzon raport për shuma të paguara koncesionare për çdo koncesion veçmas.

Mbikqyrjen inspektuese e bën Inspektorati shtetëror për inspektim teknik, nëpërmjet inspektorëve gjeologjik, minierik shtetëror dhe inspektorët për elektrikë në minieri, dhe Inspektorati është i detyruar çdo muaj, deri te Ministria për ekonomi të dorëzon raport për mbikqyrjet e kryera inspektuese. Mbikqyrjen inspektuese në lidhje me dispozitat e Ligjit për lëndë të para minerale në pjesën e mjedisit jetësor e bën Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor. Ministria e punëve të brendshme (MPB) bën mbikqyrje të hulumtimeve gjeologjike dhe eksploatimeve të lëndëve të para minerale pa koncesion dhe pa licencë. Në përgjithësi, si dhe në sferat tjera të mjedisit jetësor, “komunikimi dhe koordinimi mes inspektorëve të autorizuar për mjedis jetësor nga njësitë për vetëqeverisje lokale dhe Inspektoratit shtetëror për mjedis jetësor është në nivel të pamjaftueshëm. ISHMJ në bashkëpunim me MPB, me drejtorinë doganore, me organet gjyqësore(gjyqe dhe prokurori) dhe me ekspertë të sferës duhet të vendos një platformë në nivel kombëtar për bashkëpunim të detyrueshëm të vazhdueshëm dhe të koordinuar, në pajtim me protokole dhe procedura të caktuara standarde.

Inspektoratet komunale nuk e kanë nivelin e duhur të përvojës dhe informatave si Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor, ende nuk ka nje bazë unike e të dhënave(në nivel qendror dhe lokal) të subjekteve ligjore që janë ndotës potencial të mjedisit jetësor, dhe ISHMJ nuk është i lidhur nëpërmjet një platforme të caktuar me inspektorët lokal"(Blinkov, 2020).

Mbikqyrja inspektuese mund të jete e regullt(e paralajmeruar), e çregullt(e paparalamëruar) dhe mbikqyrje kontrolluese. Shërbimet inspektuese pregadisin plane vjetore dhe periodike për zbatimin e mbikqyrjes inspektuese në bazë të vlerësimit të rrezikut. Gjatë shkallës të lartë të rrezikut, bëhet më së paku një mbikqyrje inspektuese në vit mbi një subjekt të caktuar, në rast të nivelit të mesëm të rrezikut, më së paku një mbikqyrje inspektuse në dy vite dhe në rast të shkallës të ulët të rrizikut, më së paku një mbikqyrje inspektuese në tre vite. Sipas Ligjit për lëndë të para minerale, inspektorët e minierëve duhet të bëjnë kontrollë mbi koncesionerët më së paku tre herë në vjet. Si do qoftë, në ligj nuk eshtë e paraparë përgjegjësia dhe sanksionet për inspektorët të cilët nuk do të veprojnë në bazë të këtij detyrimi ligjor. Nëse inspektori konstaton paregullsi të cilat paraqesin rrezik për sigurinë e njerëzve dhe pronës, duhet të urdhëron që paregullsitë të largohen në afat prej 30 ditësh. Nëse në atë afat nuk largohen parregullsitë, inspektori duhet ta ndalon kryerjen e hulumtimeve të detajuara gjeologjike, performancën e puneve në minierë dhe eksploatimit të lëndëve të para materiale në një pjesë, ose në gjithe minierën (neni. 108). Inspektori duhet ti ndalon punët e mëtutjeshme çdoherë kur do të përcakton se ato kryhen pa koncesionin e duhur, leje ose pëlqim, kur punët nuk kryhen sipas dokumentacionit proektues ose teknik dhe sipas kushteve të parapara me Ligjin për lëndë të para minerale(neni 112). Në këtë rast, MPB duhet përkohësisht ti largon mjetet me të cilat bëhet gërmimi dhe transporti, si dhe lënda e parë minerale më e gërmuar. Derisa gjatë kryerjes të mbikqyrjes inspektuese konstatohet se është bërë shkelje ose vepër penale, inspektori duhet menjëherë të paraqet kërkesë për ngritjen e kallëzimit penal ose të kundërvajtjes para gjykatës kompetente. (neni 114). Nëse inspektorët konstatojnë paregullsi dhe gjatë asaj nuk marrin masat e duhura, do të konsiderohet se ata kanë bërë shkelje të rëndë të detyrës zyrtare (neni, 107).

Por, në përgjithësi, inspektorët ose pjesëtarët e MPB që nuk kanë dituri të mjaftueshme të punojnë një rast të veprës kriminele nga sfera e mjedisit jetësor dhe ta pregadisin dokumentacionin për prokurorët(ato janë vepra zyrtare për të cilat procedura fillon me menyrë zyrtare), prokuroria nuk shkon në teren të hetojë çështjen, por e mer dokumentacinin nga MPB, dhe në bazë të saj e themelon rastin.

2.1.1 Probleme gjatë mbikqyrjes të menaxhimit të lëndëve të para minerale

Numër i vogël i inspektorëve dhe dënime të shqiptuara nga ana e Inspektoratit shtetëror për inspektim teknik

Fakti që Inspektorati shtetëror për inspektim teknik bën mbikqyrje të drejtëpërdrejtë mbi zbatimin e Ligjit për lëndë të para minerale, të cilët, janë të përcaktuara si të mira në interes publik, kjo e bën një nga inspektoratet më të rëndësishëm në shtet. Por, efikasiteti i shërbimeve inspektuese kushtëzohet nga numër i mjaftueshëm i inspektorëve, kuadër mirë i trajnuar, kushte dhe pajisje bashkëkohore teknike si dhe mjete për punë.

Në lidhje me numrin e të punesuarve, në Dokumetin strategjik të ISHIT 2020-2022 thuhet se në ISHIT janë punësuar gjithsej 21 nënpunes shtetëror(dhe, sipas asaj, është një nga organet më të vogla inspektuese në shtet), nga të cilët një është udhëheqës i sektorit, dy janë udhëheqës të repartit, nëntë janë inspektorë shtetërorë dhe nëntë janë nënpunës administrator profesional. Regulloret për sistematizim të vendeve të punës, parashikojnë se numri i nënpunësve shtetëror duhet të jetë 46, gjegjësisht më tepër se dyfish(Inspektorati shtetëror për inspektim teknik,2020).

Efikasiteti i inspektoratit mund të vlerësohet dhe sipas numrit të mbikqyrjeve të realizuara dhe të planifikuara në kuartale.

Tabela 1 Mbikqyrje të planifikuara dhe të realizuara inspektuese dhe masat e shqiptuara , ISHIT, 2019

Mbikqyrje Viti 2019	I regullt		I çregullt		kontrollues		Gjithsej		Masa
	planifikuara	realizuara	planifikuara	realizuara	planifikuara	realizuara	planifikuara	realizuara	Të shqiptuara
I kuartal	209	250	0	22	0	2	209	274	8
II kuartal	187	237	0	17	0	13	187	267	15
III kuartal	175	230	7	68	7	14	189	312	40
IV kuartal	/	172	/	26	/	18	/	216	17
Gjithsej	**571**	**889**	**7**	**133**	**7**	**47**	**585**	**1069**	**80**

Burim: Të dhëna të mbledhura nga raportet e IS, 2019.

Gjatë vitit 2019, janë realizuar gjithsej 899 mbikqyrje të regullta, 133 mbikqyrje të çregullta dhe 47 mbikqyrje kontrolluese (gjithsej 1069 mbikqyrje inspektuese). Gjatë kësaj janë konstatuar gjithsej 80 paregullsi. Sipas tabelës, në kuartalin e tretë, ISHIT ka numër më të madh të mbikqyrjeve të kryera inspektuese të çregullta, për dallim nga kuartalet tjera(gjithsej 68), kur janë shqiptuar dhe numër më i madh i masave inspektuese. Raporti i masave të shqiptuara në raport me numrin e mbikqyrjeve të kryera, sipas raporteve të këshillit Inspektues, nuk është i lidhur me ekipimin në kuadër, por direkt varet nga problematika mbi të cilën shërbimi inspektues bën mbikqyrje, dhe është tregues i rëndësishëm për marrjen e masave dhe politikave me qëllim të përmirsimit të sistemit inspektues, kontrollë më efikase e subjekteve të mbikqyrjes, si dhe mbrojtje më e madhe e interesit publik (RMV. IS 2020). Pjesëmarrja e masave inspektuese të shqiptuara në raport me mbikqyrjet për vitin 2019 është 7.5 perqind, që tregon në numër shumë të vogël të masave të shqiptuara në raport me numrin e mbikqyrjeve.

Llogaridhënie e ulët e Inspektoratit shtetëror për inspektim teknik

Në web-faqen e ISHIT nuk është shpallur raporti për punën e tij dhe për mbikqyrjet e kryera për gjashtë muajt e para të vitit 2020, edhe pse Ligji për mbikqyrje inspektuese e imponon atë. Përkatësisht, sipas nenit 99 të këtij ligji, parashikohet një gjobë prej 450 euro për drejtorin, udhëheqësin e shërbimit inspektues, nëse nuk e shpall në web-faqe të shërbimit inspektues raportin për punën gjashtë mujore, më vonë deri 15 korrik, për periudhën janar-qershor, gjegjësisht më vonë deri 15 janar, për periudhën korrik-dhjetor të vitit të mëparshëm, dhe në qoftë se në këtë afat nuk e deponon raportin deri te keshilli Inspektues në formë elektronike dhe në formë të shkruar, gjobën për shkeljen duhet ta shqipton Inspektorati shtetëror administrativ. Me ketë nuk mundësohet e drejta e qasjes deri në infromata të karakterit publik të cilat Inspektorati është i detyruar regullisht ti shpall dhe ti azhuron.

Nivel i ulët i koordinimit mes inspektoratëve shtetëror për inspektim teknik dhe për mjedis jetësor

Gjatë mbikqyrjes të eksploatimit të lëndëve të para minerale, Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor përcakton a posedon instalacioni licencë për eksploatim, dhe a kanë dorëzuar koncesionerët raport vjetor deri te organi kompetent shtetëror, bën kontrollë në evidencat për hedhurina të rrezikshme nga instalacionet me licencë të integruar ekologjike A, gjegjësisht B, dhe kontrollon a i plotëson kushtet të parapara me licencën për eksploatim për

largimin e hedhurinave, duke i përfshirë dhe vlerat kufizuese të emisoneve në ajër, ujë dhe në truall.

Si do qoftë, gjatë ndërtimit të instalacioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale, ISHIT dhe ISHMJ, rallë herë bëjnë mbikqyrje të koordinuar inspektuese. Kjo është e domosdoshme që në mënyrë të integruar të përcjellet se a zbatohen masat për korrektësi teknike në faza të caktuara të objekteve dhe pajisjes, dhe të kontrollohen emisionet e materieve ndotëse. Në kohë të eksploatimit, ISHMJ gjatë kryerjes të mbikqyrjes duhet të siguron matje të pamvarur të emisioneve, dhe në mënyrë plotësuese edhe për matjet që i bëjnë vetë instalacionet në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor. Duhet të bëhen matje të regullta dhe të çregullta të më tepër parametrave për ndotjen a ajrit, ujit dhe truallit, dhe dënimet për shkeljet ekologjike dhe havaritë të jenë shumë më të larta, pa mundësi për ujdi nëse pagohen më herët, si dhe mbyllje e objekteve në rastet kur hulumtimi do të tregon se janë burim i ndotjes të përheshme të rrethinës për shkak të teknologjisë të vjetër ose joadekuate, të cilat në UE nuk do të kishin guxuar ta përdorin për shkak të normave shumë më të larta ekogjike(Popovska, 2020). Matjet e pamvarura duhet ti kryen laborator shtetëror i akredituar, i cili pritet të fillon me punë në fillim të vitit 2021. Përveç laboratorit të pavarur të akredituar, për zbatim efikas i mbikqyrjes inspektuese është e domosdoshme të bëhet furnizim dhe me pajisje adekuate për punë. Për shembull, e duhur është të pajisemi me pajisje për matje indikative të emisioneve në ajër, me të cilën do të vërtetohet nevoja për angazhimin e laboratorit të akredituar të bën matje të parametrave specifike, në varshmëri nga rezultati i matjes indikative. Niveli i ulët I koordinimit dhe komunikimit mes institucioneve sjell deri te një sërë lëshimesh dhe paregullsish, mes të cilave dhe pagesa e shumave nga ana e koncesionerëve (Petrovska, 2020).

Shqiptimi i paralajmerimeve gjatë shkallës të lartë të rrezikut

Ligji për mbikqyrje inspektuese dhe ligji për kundërvajtje parashohin paralajmërimin si masë primare parandaluese. Ashtu, gjatë përcaktimit të paregullsisë që ndodh për herë të parë, inspektori duhet të formon shkresë në të cilën do ta përcakton paregullsinë e bërë, do të tregon se ajo duhet të largohet në afat prej tetë ditësh dhe njëkohësisht duhet të jepet ftesë për kryerjen e edukimit të personit ose të subjektit ku është percaktuar parregullsia gjatë mbikqyrjes. Nëse gjatë mbikqyrjes kontrolluese inspektori përcakton se nuk janë të larguara paregullsitë e përcaktuara, atëherë paraqet një kërkesë për zhvillim të procedurës për kundërvajtje para gjyktës kompetente. Por, eksploatimi i lëndëve të para minerale, që paraqesin resurse të kufizuara

dhe të paripërtrirshme, dhe veprimet për përpunim të mineraleve që janë të lidhura me përdorimin e kimikateve të rrezikshme, shkaktojnë dëme materiale ose pasoja negative për mjedisin jetësor dhe për shëndetin dhe sigurinë e njerëzve. Çdoherë në këto raste egziston shkalla e lartë e rrezikut, dhe masat represive dhe dënimi do të kihhin dhënë rezultate më të mëdha në ndalimin e pasojave serioze.

Sipas dispozitave nga Ligji për lëndë të para minerale(kreu X), lartësia e gjobave, në varësi nga pesha dhe lloji I shkeljes, është prej 2500 deri 250.000 euro.

Jokoordinimi i ligjeve për mbikqyrje inspektuese për lëndë të para minerale

Ligji për mbikqyrje inspektuese e përfshin dhe Inspektoratin shtetëror për inspektim teknik dhe për atë arsye nevojitet koordinimi i Ligjit për lëndë të para minerale me këtë ligj. Për Ligjin për lëndë të para minerale, këshilli inspektues më ka pregaditur mendim pozitiv, por ligji ende nuk ëhtë i koordinuar me Ligjin e ri për mbikqyrje inspektuese dhe pritet që të koordinohet në të ardhmen. (Këshilli inspektues, 2020).

2.2 Mbikqyrje mbi menaxhimin me pyjet

Sipas Ligjit për pyjet, mbikqyrjen inspektuese të menaxhimit me pyjet e bën Inspektorati shtetëror për pylltari dhe gjueti(ISHPGJ) , ndërsa pyjet i mbrojnë Policia pyjore dhe Shërbimet për rroje të pyjeve- organe që funkcionojnë në kuadër të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujit. Mbikqyrja dhe kontrolli i shitjes të drurit, sipas të njejtit ligj, bëhet nga ana e Inspektoratit shtetëror të tregut.

Inspektorati shtetëtor për pylltari duhet të bën kontrollë mbi kultivimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve, si dhe mbi gjithë vendet ku prehet druri, largohet nga pylli, transportohet, bartet, përpunohet ose lëshohet në shitje, duke i përfshirë edhe mjetet me të cilat druri bartet ose transportohet. Inspektorët duhet ta kontrollojnë zbatimin e planeve për ekonomizimin me pyjet nëpërmjet kërkimit të të dhënave për reprodukcion të kryer, shfrytëzim, kultivim dhe mbrojtje të pyjeve, si dhe të bëjnë kontrollë në punën dhe dokumentacionin e subjekteve ligjore të cilët kanë licencë për prerje dhe bartje të drurit. Ato munden përkohësisht të ndalojnë dëme në raste urgjente(prerje e pyjeve, gërmim ose kullotje e kafshëve),me të cilat do të bëhet dëm në interes

publik, deri në vendimin përfundimtar të organit kompetent. Nëse konstatojnë paregullsi, dhe nuk janë të autorizuar të veprojnë në mënyrë direkte, inspektorët duhet ti njoftojnë organet kompetente dhe ndërmarjen publike "Pyjet kombëtare" dhe të kërkojnë intervenimin e tyre.

Të drejtat dhe obligimet e të gjithë subjekteve të cilat nënshtrohet në mbikqyrje inspektuese janë regulluar me nenin 63 të Ligjit për mbikqyrje inspektuese, me të cilin përcaktohet se subjekti i mbikqyrjes duhet ti mundëson inspektorit qasje deri te hapësirat, prodhimet, bazat elektronike të të dhënave ose deri te cili do mjet i cili është objekt i mbikqyrjes inspektuese, si dhe qasje në dokumentacionin e plotë dhe informatave të duhura për përcaktim të gjendjes faktike. Nëse subjekti i mbikqyrjes nuk vepron sipas detyrimeve që i ka, do të jetë i detyruar të pagon gjobë me shumë prej 750 euro si subjekt juridik, gjobë 250 euro për subjektin përgjegjës në subjektin juridik, gjegjësisht gjobë prej 150 euro për kryesin e kësaj shkeljeje- subjekt fizik.

Sipas Ligjit për mbikqyrje inspektuese, derisa inspektori i pyjeve konstaton ndonjë parregullsi, është i detyruar ti urdhëron subjektit në afat prej tetë ditësh të marrë masa konkrete për largimin e asaj parregullsie. Nëse gjatë mbikqyrjes kontrolluese inspektori konstaton se parregullsia nuk është larguar, paraqet kërkesë për nisje të procedurës për kundërvajtje para organit kompetent. Me këtë masë vjen deri në shprehje funkcioni parandalues i mbikqyrjes inspektuese dhe parimit të proporcionalitetit, derisa këto parregullsi dhe mangësi nuk shkaktojnë rrezik direkt për jetën dhe shëndetin e njerëzve, kërcënim për mjedisin jetësor ose kërcënim të interest publik.

2.2.1 Porbleme gjatë mbikqyrjes të menaxhimit me pyjet

Numër i vogël i inspektorëve dhe urdhërpagesa nga Inspektorati shtetëror për pylltari dhe gjueti

Inspektorati shtetëror për pylltari dhe gjueti duhet të bën mbikqyrje inspektuese mbi 1.002.809 hektarë pyje dhe tokë pyjore në pronësi shtetërore dhe private, të regulluara në 176 plane të ndara për ekonomizim me pyjet, si dhe mbi 249 vende për gjueti të dhëna me koncesion për shfrytëzim, kultivim dhe mbrojtje të kafshëve të egra(RMV. MBPEU 2020). Por, ISHPGJ nuk korespondon me resurse të mjaftueshme humane, përkatësisht numri i të punësuarve është diçka më i madh nga gjysma e kuadrit të duhur (në vitin 2019 janë notuar 20 inspektorë, dhe me sistematizim janë paraparë 34 inspektorë), që sjell deri në efektivitet të zvogëluar të inspektoratit

Tabela 2:Mbikqyrje inspektuese të planifikuara dhe të realizuara dhe masa të shqiptuara , ISHPGJ, 2019

mbikqyrje 2019	Regullt		çregullt		kontrollues		Gjithsej		Masa
	planifikuara	realizuara	planifikuara	realzuara	planisfikuara	realizuara	planifikuara	realizuara	Të shqiptuara
I kuartal	636	726	20	145	28	99	684	970	97
II kuartal	716	533	2	206	20	53	738	792	98
III kuartal	652	541	5	208	12	53	669	802	135
IV kuartal	/	665	/	172	/	100	/	937	104
Gjithsej	**2004**	**2465**	**24**	**731**	**60**	**305**	**2088**	**3501**	**434**

Burim: RMV. ИS viti 2019

Të dhënat për tre kuartalet e para të vitit 2019 tregojnë se janë kryer 2.564 mbikqyrje inspektuese, dhe janë shqiptuar 330 masa. Pjesëmarja e masave të shqiptuara inspektuese në raport me mbikqyrjet e kryera tregon në shkallë të ulët të dënueshmërisë të subjekteve të mbikqyrjes-13 përqind, derisa në teren janë evident numër i madh i kundërvajtjeve. ISHPGJ, në tre kuartalet e para të vitit 2019, shënon vetëm një kallëzim penal dhe 12 kallëzime për kundërvajtje. Deri në fund të vitit , janë kryer gjithsej 3.501 mbikqyrje inspektuese dhe gjatë kësaj janë shqiptuar 434 masa inspektuese. Që të përmirsohet efektiviteti i Inspektoratit, duhet të ngritet dhe niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit me policinë pyjore, policinë kufitare, qendrës për menaxhim me krizat(QMK), Direkcionit për mbrojtje dhe shpëtim(DMS), si dhe me organet gjyqësore qe duhet ti procesuojnë kallëzimet në periudhë më të shpejtë.

Përputhje e ingerencave të policisë pyjore dhe shërbimit për rroje të pyjeve

Ligji për pyjet parasheh ruajtja e pyjeve në pronësi private dhe shtetërore të bëhet në dy nivele, edhe atë në mënyrë kotrollore-patroluese dhe rajonike. (neni 81). Ruajtjen kontrolluese patroluese e bën policia pyjore në suaza të MBPEU, e cila është e organizuar si njësi qëndrore organizative, me seli në Shkup dhe me 30 stacione të policisë pyjore nëpër gjithë teritorin e shtetit. Në sektorin e policisë pyjore janë paraparë 439 vende pune, ndërsa janë

mbushur 375 ose 82 përqind. Në sektorin për kontrollë të mbrendshme, janë paraparë 8 vende pune, por nuk është mbushur asnjë. Rrojen rajonike e bën shërbimi për rroje te pyjeve në përbërje të Ndërmarjes publike për ekonomizim me pyjet shtetërore "Pyje Kombëtare" dhe subjektet tjera që ekonomizojnë dhe menaxhojnë me rajonet e mbrojtura pa marrë parasysh për çka përdoren. Anëtarët e policisë pyjore dhe shërbimeve për rroje të pyjeve jane të autorizuar ti mbrojnë pyjet nga vjedhje dhe zjarre, ti legjitimojnë personat që i takojnë në pyll, të bëjnë konfiskimin të përkohshëm të mjeteve dhe objekteve, të paraqesin kërkesa për ngritje të kallezimeve penale dhe kundërvajtjeve dhe gjëra të ngajshme.

Nga ajo çka përmendëm më lartë mund të konstatojmë se kompetencat e anëtarëve të policisë pyjore dhe shërbimeve për rroje të pyjeve në pjesë të madhe përputhen, dhe për atë nevojitet kufizimi i atyre, por edhe përforcim i bashkëpunimit dhe riorganizim i tyre- për shembull, ato mund të bashkohen në një shërbim, në të cilin do të mund të funksionojnë si dy njësi të ndara- sepse praksa tregon se kur dy subjekte(organe, shërbime, institucione...) kanë autorizime identike, lehtë neglizhohen dispozitat ligjore dhe detyrimet në veprime, dhe gjatë kësaj nuk meret asnjë përgjegjësi.

Sulme mbi policët e pyjeve nga ana e prerësve illegal të pyjeve

Puna e anëtarëve të policisë pyjore është shume e rëndë për shkak të sjelljes agresive që e kanë kryesit e veprave penale të shkrretimit të pyjeve. Kur policia pyjore arrin në vendin ku është kryer vepra penale, kryesit i praptojnë automjetet dhe karrocat që ti ndalojnë policët ti konfiskojnë dhe më tej largohen nga vendi i ngjarjes. Disa nga kryesit kanë edhe qen që i paralajmërojnë për rrezikun që afrohet, ndonjëherë ndodh ti sulmojnë dhe ti lëndojnë policët pyjorë me gurrë ose me sharra motorike kur do të jenë të kapur në vend, që kjo ka rezultuar edhe me raste të vdekjesh. Për atë, policia pyjore shpesh herë kerkon asistencë nga policët e MPB për kryerjen e disa akcioneve në teren. Por, numri i vogël i punjonësve policor dhe mungesa e pajisjes materiale, e pengojnë luftën efikase kundër prerjes jolegale. Një pjesë e veprave të kryera penale janë rezulatat i grupeve të organizuara kriminele. (Media Servis Maqedonas, 2020).

Inspektorati shtetëror për pylltari dhe gjueti nuk ka vendshpallje personale publike

Inspektorati shetëror për pylltari dhe gjueti, edhe përkrah detyrimit ligjor për egzistim të vendshpalljes publike, nuk ka veb-faqe të vetë. Publiku nuk ka kontrollë në punën e këtij inspektorati, as nuk ka qasje të shpejtë deri te programet vjetore, raporte dhe të dhëna tjera relevante që duhet të shpallen

në mënyrë publike dhe duhet të jenë në dispozicion për të gjithë. Me këtë është thyer parimi për publicitet dhe transparencë, dhe organizatat qytetare, gazetarët dhe qytetarët tjerë kanë qasje të kufizuar deri te informatat me karakter publik.

Joharmonizim e dispozitave ligjore

Nevojitet sjellje e ligjit të ri me të cilin do të regullohen kompetencat dhe organizimi i Inspektoratit shetetëror për pylltari dhe gjueti, si dhe gjithë çështjet tjera të lidhura me mbikqyrjen inspektuese mbi pyjet, dhe të cilat do të jenë në pajtim me ligjet tjera në sferë, dhe posaçërisht, me Ligjin për mbikqyrje inspektuese. Ligji i ri, për shkak të unifikimit të termeve dhe titujve, duhet të quhet Ligj për Inspektorat shtetëror për pylltari dhe gjueti.

Më tej, dispozitat e Ligjit për inspektim pyllor dhe për gjueti dhe nga Ligji për pyjet nuk janë të koordinuara me Ligjin për mbikqyrje inspektuese. Hasim në dispozita që gjinden në Ligjin për mbikqyrje inspektuese dhe në dy ligjet tjera, me çka është e panevojshme të ngarkohet përmbajtja e tyre. Për shembull. neni 100, paragrafi 5 nga Ligji për pyjet paraqitet edhe në Ligjin për mbikqyrje inspektuese dhe thotë: „Subjektet që ekonomizojnë me pyjet dhe subjektet që i zbatojnë planet për kultivim dhe mbrojtje të pyjeve ne rajonet e mbrojtura, subjektet tjera ligjore dhe qytetarët, puna e të cilëve i nënshtrohet mbikqyrjes nga ana e inspektorëve shtetëror për pylltari dhe gjueti, janë të detyruara ta mundësojnë kryerjen e mbikqyrjes dhe ti dorëzojnë të dhënat e duhura". E tillë është edhe dispozita në nenin 7 nga Ligji për inspektim pyjor dhe për gjueti, dhe e cila i takon parimit të proporcionalitetit e regulluar me nenin 13 nga Ligji për mbikqyrje inspektuese, sipas të cilit inspektori shqipton masa inspektuese në pajtim me ligjin, që janë të domosdoshme për largimin e parregulsive të përcaktuara dhe mangësive dhe janë më të volitshme për subjektin e mbikqyrjes inspektuese, gjatë së cilës duhet të kemi kujdes mos të ndalohet funksionimi efikas i subjektit të mbikqyrjes inspektuese.

Me dispozita persëritëse në mënyrë të panevojshme ngarkohet teksti ligjor, sepse materiali i përmendur vetëm më është i regulluar me dispozita identike në Ligjin për mbikqyrje inspektuese.

2.3 Mbikqyrje të menaxhimit me tokë bujqësore të përpunueshme

Mbikqyrjen mbi zbatimin e veprimeve për dhënie me qera të tokës bujqësore shtetërore e bën Ministria për bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujit. Që të jepet me qera toka bujqësore në pronësi shtetërore për sipërfaqe deri 3 hektarë, ministri për bujqësi shpall ankand publik, pas miratimit paraprak nga Qeveria. Procedurën e zbaton komisioni i përbërë shtatë anëtarësh, i formuar nga Qeveria me propozim të Ministrit: dy përfaqësues të MBPEU, një përfaqësues nga shoqatat nga sfera e bujqësisë, një përfaqësues nga Bashkësia e njësive për vetëqeverisje lokale në teritorin e të cilit shpallet toka, një përfaqësues i propozuar nga Zyra e kryetarit të Qeverisë, një përfaqësues i propozuar nga nënkryetari i Qeverisë për çështje ekonomike dhe një përfaqësues i propozuar nga Ministria e financave. Procedura e shpalljes publike për sipërfaqe mbi 3 hektarë kryhet me anë të ankandit publik elektronik. Mënyra e postimit e përmbajtjes e shpalljes për sipërfaqe mbi 3 hektarë, si dhe dokumentacioni i duhur, janë regulluar me Ligjin për tokë bujqësore(Kreu 3, neni 21-28).

Mbikqyrje inspektuese, kryhet nga më teper inspektorate- Inspektoratit shtetëror për bujqësi(ISHB) e kontrollon zbatimin e dispozitave të Ligjit për tokë bujqësore dhe regulloreve të sjellura në bazë të saj, Inspektorati shtetëror adminsitrativ bën mbikqyrje në lidhje me ligjshmërine të veprimeve te veçanta administrative, dhe inspektorët për ndërtim të Qytetit të Shkupit dhe të komunave bëjnë mbikqyrje të ndërtimeve mbi tokë bujqësore, në pajtim me Ligjin për ndërtim. Nuk egziston koordinim mes Inspektoratit për bujqësi dhe Inspektoratit për ndërtim, dhe kjo ishte shumë e dukshme kur në bregun afër Strugës- rajon me status të thesarit natyror dhe kulturor të UNESKO- u lind një ndërtim jolegal, dhe asnjë nga inspektoratët kompetente nuk reagoi, duke e hedhur fajin mes njëri tjetrit.

Mbikqyrja e Inspektoratit shtetëror për bujqësi është orientuar kah mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja nga materiet e dëmshme, zbatimit të dispozitave nga marrëveshjet për qera, zbatimit të dispozitave për ridedikim të tokës bujqësore, marja e masave për mbrojtje nga zjaret, si dhe punë tjera (Ligji për tokë bujqësore, neni 57). Për largimin e parregullsive të përcaktuara, inspektori mund ti tregon subjektit për parregullsitë dhe ti urdhëron të mer masa adekuate dhe aktivitete për largimin e tyre, përkohësiht t'ia ndalon kryerjen e aktivitetit dhe t'ia konfiskon mjetet me të cilat është kryer vepra penale ose kundërvajtja, si dhe të ngrit kërkesë për procedurë penale ose të ngrit procedurë penale(neni 15-a). Nëse parregullsitë janë kryer për here të parë, inspektori duhet ti propozon subjektit ti largon në afat pre 8 ditë dhe ti jep ftesë për edukim në raste kur do të vërtetohet se një subjekt i caktuar nuk

e shfrytëzon token bujqësore në pajtim me rolin e saj ose nuk e ka njoftuar MBPEU se toka bujqësore ka ndaluar së qeni tokë bujqësore për shkak të ridedikimit të përhershëm (neni 58). Lartësia e gjobave varet na pesha e shkeljes të bërë dhe nga ajo se a bëhet fjalë për shoqëri tregtare të vogël, të mesme ose të madhe, dhe ato në pajtim me Ligjin për shkelje, janë prej 1000 deri 2000 euro, për shoqëri tregtare të vogël, nga 3000 deri 6000 euro, për të mesme dhe të madhe (neni 59). Para se të ngritet procedurë kundërvajtjeje, Ministria e bujqësisë ngrit procedurë për lëshimin e urdhërit për pagesë të kundërvajtjes në pajtim me Ligjin për kundërvajtje. Kryesi i cili do ta paguan gjobën në afat prej 8 ditëve do të paguan vetëm gjysmen e gjobës të shqiptuar.

2.3.1 Probleme gjatë mbikqyrjes të menaxhimit me tokë bujqësore të përpunueshme

Numer i vogël i urdhërpagesave dhe numër i pamjaftueshëm inspektorë në Inspektoratin shtetëror për bujqësi

Inspektorati shtetëror për bujqësi, sipas numrit të inspektorëve dhe sipas ligjeve sipas të cilëve është kompetent të vepron, paraqet një nga shërbimet inspektuese më të medha në shtet. Ky inspektorat duhet të modernizohet në aspekt të pajisjeve për punë, të ritet numri i inspektorëve dhe të zbatohet planifikim më efikas dhe realizim më efikas i mbikqyrjeve inspektuese. Në lidhje me numrin e inspektorëve, në vitin 2019 kane punuar gjithsej 114 inspektorë nga 157 vende për ispektorë të parapara sipas sistematizimit (73 përqind). Plus asaj, strukrura e moshës e inspektorëve është e pavolitshme dhe është e domosdoshme të punesohen dhe të trajnohen inspektorë të ri. Në vitin 2019 konstatohet se gjithsej 21,3 përqind nga inspektorët janë me moshë mbi 60 vjeçare(Këshilli inspektues, 2020).

Gjatë tërë vitit 2019, jane evidentuar gjithsej 47.980 mbikqyrje të kryera inspektuese, nga të cilat: 2.726 mbikqyrje të regullta, 44.444 mbikqyrje të çregullta dhe 810 mbikqyrje kontrolluese, dhe gjatë kësaj janë përcaktuar gjithsej 1.262 parregullsi. Disproporcioni mes mbikqyrjeve të kryera dhe masave të shqiptuara është i madh, dhe ashtu, pjesëmarrja e masave të shqiptuara është vetëm 3 përqind në raport me numrin e përgjithshëm të mbikqyrjeve. Nëse i krahasojmë të dhënat për numrin e mbikqyrjeve dhe masave nga viti 2019 dhe 2018, në vitin 2019 janë kryer 3.080 mbikqyrje inspektuese më teper se në vitin 2018, por edhe përkrah këtij dallimi në numrin e mbikqyrjeve, numri i masave të shqiptuara nuk ka dallim të madh.

Tabela 3: Mbikqyrje inspektuese të planifikuara dhe te realizuara dhe masa të shqiptuara, ISHB, 2019.

mbikqyrje viti 2019	Regullt		Çregullt		Kontrollues		Gjithsej		masa
	planifikuara	realizuara	planisifikuara	realizuara	planifikuara	realizuara	planifikuara	realizuara	Shqiptuara
I kuartal	723	683	8030	10310	61	196	8814	11189	275
II kuartal	732	690	8918	10773	86	232	9736	11695	269
III kuartal	718	660	8479	10455	101	156	9298	11271	254
IV kuartal	/	693	/	12906	/	226	/	13825	464
Gjithsej	**2173**	**2726**	**25427**	**44444**	**248**	**810**	**27848**	**47980**	**1262**

Burim: RMV. IS 2019

Numër i madh i mbikqyrjeve inspektuese

Një fakt tjetër që del nga të dhënat raportuese është numri tejet më i madh i mbikqyrjeve të çregullta në raport me mbikqyrjet e regullta- 44.444 mbikqyrje të çregullta kundër 2.726 mbikqyrje të regullta. Në raportet e Këshillit inspektues regullisht ceket se pjesëmarja e lartë e mbikqyrjeve të regullta në numrin e përgjithshëm të mbikqyrjeve nëpër institucione të ndryshme tregon se resurset drejtohen në mënyrë efikase dhe shfrytëzohen mirë, ndërsa pjesëmarrja e lartë e mbikqyrjeve të çregullta në shërbime të caktuara inspektuese tregon në nevojën për ritje adekuate të resurseve materijale dhe humane në këto institucione, me qëllim të funskionimit të tyre normal në rast të ritjes të paparashikueshme të vëllimit të aktivitetit. Planifikimi i përafert i mbikqyrjeve inspektuese të çregullta mund të arrihet në bazë të analizës të numrit të mbikqyrjeve të kryera të çregullta në kuartalet paraprake, dhe mesatarja e mbikqyrjeve të kryera në kuartalet paraprake do të merret si reper për planifikimin të mbikqyrjeve te çregullta për kuartalin e ardhshëm, por lëshime nuk duhet të ketë te mbikqyrjet e regullta, sepse ata janë të planifikuara në bazë të programit vjetor për punë të shërbimeve inspektuese, sipas të cilës bëhen kuartalet dhe planet mujore.

Inspektorati shtetëror për bujqësi nuk e azhuron veb-faqen në kohë

Nga ana e Inspektoratit shtetëror për bujqësi nuk respektohet parimi për publicitet dhe transparencë, mungojnë raporte, programe dhe dokumente tjera relevante të cilat Inspektorati është i detyruar në mënyrë publike dhe regullisht ti poston dhe të azhuron në veb-faqen, me çka do te jenë në dispozicion nga publiku më i gjërë, i cila ka drejtë të ketë qasje në to.

Dipsozita ligjore të joharmonizuara

Ndryshimet e fundit të Ligjit për tokë bujqësore nga viti 2019 janë në drejtim të harmonizimit me Ligjin për kundërvajtje, por në raportin e Inspektoratit shtetëror për bujqësi për periudhë janar- qershor 2020 tregohet nevoja për harmonizim të ligjeve materiale në sferën e bujqësisë me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje dhe me Ligjin për mbikqyrje inspektuese. Posaçërisht në pjesën e mbikqyrjes inspektuese, nevojitet harmonizim i Ligjit për tokë bujqësore dhe Ligjit për Inspektorat shtetëror për bujqësi me dispozitat e Ligjit për mbikqyrje inspektuese.

2.4 Mbikqyrje e objekteve të ekonomisë të ujit

Mbikqyrjen e objekteve të ekonomisë të ujit e bën inspektori i ekonomisë të ujit në kuadër të Inspektoratit shtetëror për mjedis jetësor, në pajtim me Ligjin për ujëra. Sektori për inspekcion i ekonomisë te ujit në ISHMJ ka vetëm dy inspektorë të ekonomisë së ujit, të cilët nuk janë të mjaftueshëm ti zbatojnë të gjitha mbikqyrjet inspektuese të duhura të regullta dhe të çregullta.

Inspektori për ekonominë e ujit ka një fushë të gjerë të veprimit dhe mbikqyr mbi subjektin “Ekonomia e ujit SHA” në lidhje me mirëmbajtjen e objekteve të ekonomisë të ujit për ujitje: digat dhe akumulacionet, kanalet dhe kyqjet për ujitje. Për gjendjen e digave, vlerësim bën operatori e sistemit për ujitje(Ekonomia e ujit SHA) dhe përpunon elaborate. Mendim për elaboratet jep Komisioni për diga, që e formon Ministria për mjedisit jetësor dhe planifikim hapërsinor.

Inspektori për ekonominë e ujit bën mbikqyrje të digave dhe akumulacioneve që shfrytëzohen për furnizim me ujë dhe e kontrollon mirmbajtjen e hidrocentraleve, përkatësisht minimumit biologjik që duhet të sigurohet në rrjedhë të digave. Ndërmarjet publike që i mirëmbajnë digat janë të detyruara të bëjnë vlerësim të gjendjes të digave, të përpunojnë elaborate

përkatëse dhe ti dorëzojnë deri te MMJPH dhe për këto elaborate mendim jep Komisioni për diga.

Në mënyrë plotësuese, inspektori bën mbikqyrje mbi digat afër tokave me ujë të minierave. Për shembull, gjatë havarisë të digës të minierës Sasa në shtator të vitit 2020, inspektori i ekonomisë së ujit pregaditi shkresë, e caktoi arsyen për havarinë, në procedurë me ujdi e mati dënimin për subjektin juridik dhe personit përgjegjës, dhe e detyroi të kryen pastrim dhe sanacion të shtratit lumor dhe terenit përreth nga materijali që u derdh. Komisioni për diga, pas incidentit, vërtetoi se derdhja e materialit është berë për shkak të filtrimit të palejuar, dhe jo për shkak të lëshimeve në punë dhe mirëmbajtjes të digës.

Inspektori i ekonomisë të ujit bën mbikqyrje edhe mbi licencat për shfrytëzim dhe lëshim të ujit nga ana e ndërmarjeve publike komunale, subjekteve fizike dhe juridike. Gjatë kësaj, mbikqyrja përfshin kontrollë të sasive të ujit dhe të mënyrës të mirëmbajtjes të akumulimit të ujit-bunarit, burimit kaptiv e tj. Për ujëmbajtës për furnizmim me ujë duhet të përpunohen elaborate për përcaktim të zonave të mbrojtura për burimin e furnizimit me ujë. Për shfrytëzimin e ujit pagohet shumë e caktuar dhe inspektori bën kontrollë a është e kryer pagesa e shumës përkatëse. Ndërmarjet komunale që kanë licencë për shfrytëzimin e ujit rallë herë paguajnë shumën e caktuar. Në ketë mënyrë shkaktohet deficit në buxhet dhe nuk mbledhen mjete të mjaftueshme për programin vjetor për ujëra që e zbaton MMJPH.

Gjithashtu, inspektori mbikqyr licencat për regullim të shtratit lumor, që merren nga ana e komunave (kur lokacioni gjendet ne rajon ndërtimor) ose Ekonomia e ujit ASH(kur lokacioni gjendet jashtë rajonit për ndërtim). Në të kaluarën, disa licenca kanë qenë të lëshuara pa u marë parasysh largësia mes dy lokacioneve të një lumi të njejtë dhe në atë mënyrë disa shtretër lumor ngelin të lëna pas dore. Te regullimi i shtratit lumor bëhen lëshime serioze, domethënë regullimi perdoret si mbulim për eksploatim "legal" të rërës dhe zhavorit. Në këtë mënyrë evitohet të ngritet procedurë për dhënie në koncesion për eksploatim të rërës dhe zhavorit.

Inspektori i ekonomisë të ujit e kontrollon dhe menaxhimin me hidrosistemin Gjavato, i cili është ndërtuar për mbushjen e Liqenit të Dojranit. Hidrosistemi më para ishte i menaxhuar nga ana e ndërmarjes publike, dhe ndonjeherë nga MMJPH. Inspektori ka të drejtë ta detyron MMJPH të dorëzon informatë deri te Qeveria që të vendoset që hidrosistemi t'i dorëzohet për menaxhim ndonjë subjekti që mundet ta mirëmban në mënyrë përkatëse dhe të mer shuma të caktuara për ujitje, sepse sistemi ka shumë numër të madh të kyqjeve joregulare për shfrytëzimin e ujit për ujitje. Inspektori i ekonomisë të ujit ka të drejtë ta detyron operatorin, në rastin MMJPH, të mundëson pagesën në pajtim me ligjin.

Sepse mbikqyrja inspektuese bëhet në nivel qendror dhe lokal, nevojitet edhe bashkëpunim efektiv mes organeve dhe institucioneve lokale dhe qendrore.


4.

Zgjidhje alternative për përmirsimin e mbikqyrjes me resurset natyrore

Kjo pjesë fokusohet mbi opcionet e mundshme për përmirsimin e politikave publike në lidhje me përmirsimin e mbikqyrjes në menaxhimin e resurseve natyrore: lëndë të para minerale, pyje, tokë bujqësore të përpunueshme dhe ujerat nëntokësore. Është shpjeguar dhe realizueshmëria e çdo opcioni për zgjidhjen e problemit të dhënë dhe është berë llogaritje e implikacioneve fiskale për zbatimin e tyre.

4.1

Zgjidhje alternative për përmirsimin e mbikqyrjes të menaxhimit me lëndë të para minerale

Nr. R.	Problem	Zgjidhje	Organ kompetent	Afat
1	Minierat me puse të hapura vazhdojne të punojnë me përdorimin e cijanidit dhe sulfurit. Në licencën e integruar ekologjike janë definuar vlerat kufizuese të emisioneve. Licencat aktuale nuk janë në pajtim me Direktivën e re për emisione industriale 2010/75/UE çka parasheh masa më të rrepta. Nevojitet revizion të licencave për shkak të harmonizimit me këtë direktivë.	Ndryshim në Ligjin per lëndë të para minerale me të cilat koncesionerët që përdorin procedura me flotacion të lëndëve të para minerale metalike në prezencë të cijanidit ose acidit sulfurik në miniera me puse të hapura do të detyrohen të përdorin masa të përgjithshme për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe zvogëlim të ndotjes kimike, dhe gjatë mbikqyrjes inspektuese patjetër të maten emisionet nga këto instalacione nga laboratore te pamvarura të akredituara.	ME	2021
2	Ndërprerje e njëanshme e marrëveshjes për koncesion për eksploatim nga ana e koncedentit në rastet kur koncesioneri nuk i përmbahet masave të caktuara me regulloret e sferës të mjedisit jetësor.	Ndryshime në Ligjin për lëndë të para minerale me të cilat saktë do të përcaktohet në cilat raste dhe ne çfarë mënyre do të mendohet se egziston rreziku, se ka ardhur deri te kërcënimi i shëndetit dhe sigurisë të njerëzve dhe mjedisit jetësor.	ME MMJPH	2021
